

Lori Papa

DUAR
DHE
BALTE

8SH-32

P 24



814-32

LONI PAPA

5

P24

DUAR DHE BALTË

Tregime, përshkrime dhe reportazhe

~~40524~~

3038

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJYRQMASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KRIMBI I FJETUR QË HAPI SYTË...

1

Eshtë një fshat malor, që quhet Hirush. Andej nuk kalon maqina. Ka pyje, male, burime. Në këto male, banorët luftojnë e nxjerrin bukë dhe nga guri.

Ishte një vajzë në Hirush, që prindët e kishin fejuar që së vogli. Ajo as e mbante mend kur ishte dhënë ajo fjalë e kur ishte ngrënë ajo gosti. Dhe zakoni pastaj çdo gjë e pështolli në qyrkun e vet.

Djali, thonë, nuk ishte i keq, prandaj fejesa nuk kishte pse të prishej. Atë e njihte babai, e njihnin të afërmit dhe askush nuk ja donte të keqen vajzës. Tusha e re jetonet në ëndërrat e vashërisë, ndonëse nuk e kishte takuar të fejuarin dhe as e kishte parë.

Thoshin që të dy ishin të mirë për shokushokun.

2

Muaji prill qeshi. Ishte prilli i vjetshëm. Në Hirush bëhej fjalë për vullnetarë që do

3

të shkonin në udhë të hekurt. Një darkë, në shtëpinë e vajzës së re të Hirushit u shtrua një kuvend:

— Po shkojnë vullnetarë, si thoni? — pyeti babai:

— Unë do të shkoj, se jam e re, — tha Tusha.

— Ne do të shkojmë si familje, — tha babai.

— Shkojmë! — thanë të tjerët.

Dhe në fshat u dëgjua se familja e Tushes do të shkonte e gjitha vullnetare. Ajo ishte ndër të parat që ju përgjegj thirrjes. Dhe fjala pastaj u përhap në fshatra të tjerë...

Fjala shkoi në vesh të Pjetrit. Ai ishte i ri. Ai e kishte parë Tushen. Dhe ajo ish e re, më e re se ai. Ai dëgjoi se ajo donte të shkonte vullnetare.

E fejuara e tij në aksion?!

3

Prilli ishte i qeshur, Pjetri i vrejtur. Thoshin që ishte i mirë, djalë në të ritë e tij, rrëth njëzet e ca vjetëve. Po ja që nga ai çast filloj të thuret ngjarja e krimbit të zi, që u zgjua nga gjumi. As pritej e as kuptohej që ai djalë i ri të ngrihej një ditë prilli e të shkonte në shtëpinë e Tushes:

— Mirë se érdhe, Pjetër! — i tha i ati i vajzës.

Po Pjetri ishte i shqetësuar. Ai kishte dicë, që e brente në shpirt.

— Do të shkojë vajza në aksion?

— Po, Pjetër!

— Atëhere unë nuk e marr.

— Qofsh shëndoshë, Pjetër! Unë kujtova se do të shkoje dhe ti.

Pjetri shtangu.
Po mandej?

4

Si je, Pjetër?

Krimbi që flinte në ndërgjegje, kishte filluar përsëri të brente. Ai ishte një krimb kryezi, i rritur së bashku me Pjetrin.

Po fjala e burrit?!

Aha, Pjetër!

Dhe fjala e vajzës është njëlloj si fjala e burrit.

Pjetri e donte Tushen, po ajo...

5

Ishte ditë prilli. Kishte dy javë që krimbi ishte zgjuar te Pjetri e kishte filluar ta brente. Ai, si burrë, kishte mbetur me turp. E vjetra ka turp e nga turpi flë thellë në ndërgjegje. Po shpesh ajo nga turpi zgjohet e trembur e përpinqet të vëré nderin në vend. Kështu ngatërohet ndërngjarje, duke u përpëlitar të dalë në krye.

Pjetri, mbas dy javësh, vinte rrëth shtëpisë së Tushes. Ai priste një çast që vajza të dilte nga shtëpia e ta rrëmbente para se të ikte vullnetare. Ai përgjonte. Sa i pëlqejnë fshehtësirat krimbit kryezi! Ai donte që Tusha të ishte robinë e tij.

Po doli nëna dhe e pa.

— Pjetër, urdhno në shtëpi!

— Kam punë me Tushen, thuaji të dalë.

5

- Ajo u regjistrua vullnetare.
- Po shkoj, nuk e marr.
- Ikë, Pjetër, ajo nuk të do.

6

— Si je, Pjetër?!

Tusha nuk shkoi vullnetare. Organizata e rinisë vendosi që ta çonte një muaj për eksperiencë në fshatrat e Myzeqesë. Andej ka fusha të gjera, ka rrugë të hekurt, ka vullnetarë që punojnë, djem e vajza plot.

Dhe Tusha punoi së bashku me shoqet dhe shokët myzeqarë.

Pjetri emrin e saj e pa dhe në gazetë. Tusha lavdërohej për sjellje të mira në punë dhe në jetë. Atëherë ai filloi t'i përkëdhelë kryet krimbit që e brente. E përkëdheli dhe e vuri përsëri në gjumë. Krimbi kryezi, në folezën e vet, kapiti sytë...

7

Kur u kthye Tusha, ai i coi fjalë:

— Ikë nga shtëpia e hajde te unë!

— Pse?

— ...

Sic duket donte të përligjte sjelljen e kaluar. Po Tusha nuk pranoi, se dhe ky nuk ishte veprim i hijshëm.

Tusha tha:

— Jo, ai desh që unë të thyeja fjalën që i

6

dhashë partisë, e tani... Unë do të shkoj në hekurudhë.

A e di Pjetër? Tusha është vullnetare këtu, në hekurudhë. Ajo është vajzë e qeshur, flokë-prerë, me shaminë e aksionit anë qafe; punon çdo ditë me shokët dhe shoqet në trase. Mbas mbarimit të turnit do të kthehet përsëri aty, për të vënë në jetë mësimet e partisë.

Ke gjë për të thënë, Pjetër?

10 prill 1968

PIKA E LARGËT

1.

Kënga thotë:

«Gjithë shoqet shkuan në punë,
Pritmëni të vij dhe unë!...»

Erdhi fanatizmi nga Gurani i mishëruar në pamjen e një burri i rreth 55 vjeçar, veshur me xhaketë me pika të zesa, me pantallona të gjëra, dhe me një kasketë në krye. Ai ishte thatanik, vështronte thekshëm me sy gllabërues dhe kish shenja shqetësimi.

Dani bëri tri ditë rrugë nga Gurani deri sa zbriti në sektorin e Mbrostarit.

Ishte mëngjez. Dielli s'kishte dalë. Vullnetarët sa ishin nisur në front. Ndonjë i vonuar, apo që vendin e punës e kishte më të afërt, ende bënë te pastrimin... Në këtë kohë ai zbriti nga makina përparrë sektorit. Deshi të hynte aty si zot në shtëpinë e vet, por roja i tha:

— Ndall!

Dani buzëqeshi dhe i shtriu dorën:

- Mirëmëngjez, djalo!
— C'dëshëroni?
— Dua të takoj... mos e njeh ti një Lule Durani?
— E njoh. Është në punë.
— E kam nusen e djalit.
— Prit të thërresim ndonjë nga të shtabit të sektorit.

Po Dani nuk priti. U mbështoll me xhaketën me pika të zeza, uli më tepër strehën e kapeles dhe u zhduk nga sytë e rojes. Kapërceu një gardh dhe u fut në sektor. Kërkonte me sy të ethshëm të gjente nusen e djalit. Vajti te çezmja, ku vajzat lanin fytyrën...

- Shoqe mos e njeh ti një Lule Durani?
— Mirëmëngjez, xhaxho! Dhe unë asaj ane jam:

— Mirëmëngjez, mirëmëngjez, po e njeh? E kam nusen e djalit.

— U nis në punë me kompaninë. E ke nuse të mirë.

Dani e mbuloi fytyrën e vet me buzëqeshje.

— Të falemnderit, moj bijë e babajt, po ku punojnë?

— Drejt trasesë.

Tani përpara tij shtrihej një trase. Ajo zgjatë dhe fundi i dy anëve i dukej sikur afrohej më shumë. Hodhi sytë se mos e shihte tej nusen e djalit, por atij ju duk sikur traseja po mbyllej në një pikë, nga nuk mund të kalohej më tutje. Dani nxitoi hapin për të arrirë sa më parë mbylljen e asaj pike, po sa më tepër vrapiqte, aqë më shumë ajo pikë largohej, dhe traseja zgjerohej e zgjerohej. Hej si dukej ai, Dani, duke vrapiuar i ve-

tëm në atë trase të gjatë! A thua do ta arrinte të renë pa filluar ende punën?!

Vrapo, Dane, vrapo! I rëndet trasesë të të mbajë mbi kurrizin e vet.

— Ku është komandanti? — pyeti ai sa arriti.

— Mirëmëngjez, xhaxho!

— Mirëmëngjez, mirëmëngjez, po dua komandantin.

Dhe ata e thirrën komandantin.

Shoqet i thanë Lules:

— Të paska ardhur vjehrri!

— Erdhi deri këtu?! Ah, fanatizmi!

Dhe ajo vazhdoi punën.

Dani shtriu krahët dhe përqafoi komandantin.

— Po si je, mor bir? A jeni mirë?

— Shumë mirë.

Dani nxori 10 lekë dhe ja dha komandantit:

— Na, jepuani vullnetarëve t'i hanë karamele.

Unë këtu kam Lulen, nusen e djalit.

Komandanti kujtoi se mos Lulja kishte ditë-lindjen.

— Është punëtore e mirë. Gjithmonë merr flamurin e skuadrës.

Dani u vrejt:

— Nuk më duhet skuadra mua, as flamuri i saj. Kam ardhur ta marr.

— Pse??

— E kanë marrë me pahir.

— Ashtu?! Po ti ke dhe 10 vajza nga fshati yt, takoi ato më parë pastaj...

— Nuk më duhen ato, dua të flas me nusen.

— Lule! — thirri komandanti dhe ndërkokë i ktheu lekët Danit. Merre parapagimin që më bëre.

Lules i ra pikë: «Na turpëroi fanatizmi»!

Lulja u afrua. Dani qeshi dhe puthi nusen në dy faqet.

— Erdha të të marr, moj bijë...

— Unë nuk vij.

— Do të vish dhe pa fjalë.

Po ajo nguli këmbë. Dani u tha të tjerëve:

— Të punoj unë e të kthehet ajo në shtëpi. Një vullnetare tha:

— Xhaxho, merr dhe ti një kazmë e puno dy muaj me nusen.

— Atë kazmë mbaje për vete. Lulja është imja. Ajo do të vijë me mua.

— Po, baba, — tha Lulja — do të vij. Hajt të shkojmë! Të mirëupafshim! — u tha ajo shoqeve.

Këtë Dani nuk e kapi. Ai tërroqi Lulen për dore dhe u nis trasesë me vrap. Kish frikë ta lëshonte se mos ikte. Përsëri dy anët e trasesë sikur bashkoheshin në një pikë të largët dhe ai nxitonte, nxitonte; shtrëngonte të renë dhe kërkonte ta nxirrte nga traseja, po ajo nuk kishte frikë. Nga prapa vinte komandanti i saj.

— Baba, shkojmë e bisedojmë në shtab të sektorit, se nuk është mirë të sillemi kështu.

— Tani që të vura në dorë...

Dhe ai u drejtua të dilte në rrugë. Roja i tha:

— Ndal! Nga hyre në mëngjez?

— Ç'të duhet ty?

— Ejani në shtab të sektorit, të bisedojmë,

— i tha komandanti i brigadës që i kishte ardhur pranë.

— Zot jam unë për nusen time.

— Baba, na turpërove! — tha Lulja.

— Prapaktheu! — tha roja.

Aty në shtab të sektorit biseda zgjati katër orë.

Dani buzëqeshi, u paraqit në halle familjare, qe gati ta zëvëndësonte Lulen në punë, dhe së fundi shfreu:

— Ngreu e folë, Lule, se të kanë marrë me pahir...

2.

Kënga thotë:

«Një mësim na dha partia...»

Kënga kish kohë që këndohej asaj ane. Dhe vajzat e djemtë e kooperativës së Gurani dilnin çdo herë në punë. Ata kishin dalë dhe më parë se të këndohej kënga. Aty në punë u përbys dhe bota e ngushtë, e ndrydhur... Lulja e Samiu e njihnin njëri-tjetrin mirë: Ata duheshin. Dhe pastaj... u gjend një lajmës sa për të vënë në dijeni familjet. Lulja u bë nuse e shtëpisë së Duranëve. Përsëri çifti i ri dilte në punë, në kooperativë, ndërsa i vjehrri i saj, Dania, ishte marangoz e shkonte fshat më fshat, ku gjente punë. Nusja e Duranëve ishte e mirë, punëtore. Për të lavdërohej vjehrra, lëvdohej vjehrri dhe krenohej fshati. Por brenda mureve të shtëpisë, qëndronte fanatizmi: bobo, sikur ta dinte ai që nusja e djali i kishin dhënë fjalën njëri-tjetrit para se të shkonte lajmësi në shtëpi!

Kaluan kohë, pesë muaj kohë. U bë një mble-dhje e organizatës së rinisë ku ndodhej Samiu e Lulja dhe gjithë të rintjtë e të rejat e kooperativës.

Lulja tha: — Dhe unë do të shkoj vullnetare në hekurudhë, sëbashku me shoqet.

Samiu tha: — Unë kam besim te Lulja, ajo do tē na nderojë.

Shokët thanë: — Ne e njohim në punë.

Pas mbledhjes ata kaluan rrugëve tē fshatit pér në shtëpi. Rrugë, rruge.. Lulja do tē nisej në një rruge tē madhe dhe kishte frikën e fanatizmit.

— Prindët e mi nuk më pengojnë që unë tē shkoj në hekurudhë, — tha Lulja. — Po prindët e tu, si do ta presin, Sami?

— Dhe tē mitë do tē binden. Do tē bisedoj unë me ta.

Në darkë Samiu i tha s'ëmës:

— Lulja do tē shkojë në hekurudhë.

— Turpi i botës: Pesë muaj martesë! ..

— Turpin e mbaj më parë unë, nënë, pastaj ju...

— Ikë dhe ti pas saj, shfryu plaka, sikur don-te t'i thoshte: «lipsur qofsh dhe ti..»

— Jo, ajo do tē shkojë vetëm, unë do ta pér-cjell. Kemi nevojë pér punë këtu në fshat.

Pastaj ai e përçolli tē shoqen:

— Rrugë tē mbarë, Lule, e dalç faqebardhë!

— Mirë tē gjeça... !

Kur iku Lulja, Dania nuk ndodhej në shtëpi.

Ai u kthyte, dhe u grind me tē shoqen; nuk e pyeti tē birin, dhe mori rrugën e gjatë, pér tē vënë në vend nderin e marrë nëpér këmbë.

Fanatizmi tanë mundohet tē ndrrojë fytyrë. Ai nuk ka më nge tē buzëqeshë.

3.

Dania tha:

«Kij mendjen!.., dëgjove?»

- Thuaj, pra, thuaj të muarën me pahir.
- Mua më përçolli Samiu, baba!
- Ik ti, rri unë.
- Ti rri, unë nuk iki.

Komandanti i sektorit tha:

— Xha Dane, katër orë e shkëputëm Lulen nga puna. Dhe ne të tjerët na pengove. Po të kesh dëshirë, jashtë planit, të sjellim dhe ty një kazmë të mirë, në mos, dalim të shohim për ndonjë makinë.

Faraatizmi ndrroi përsëri fytyrë.

— Më jepni një shkresë ku të thoni se unë erdha të marr nusen dhe ju nuk doni të ma lini.

— Unë erdha vetë baba, — tha Lulja — dhe nuk iki që këtej.

— Puno sëbashku me nusen, — tha komandanti i sektorit.

Dania heshti një çast dhe, pastaj, u largua.

— Kij mendjen! — tha ai — Dëgjove?

13 Mars 1968

BISEDA TË NDËRPRERA

— Ej, shofer!

Shoferi ndaloi.

— Ku shkoni?

— Vullnetarë, vëlla, na merr deri në Lushnjë?

— Hipni!

Dera e kabinës u përplas me forcë. Ata të dy, Muhameti dhe Seiti, përshëndetën shoferin. Maqina me targë Dr. 23-18 u largua nga Skrapari.

— Po ju,—pyeti shoferi, —të vonuar?

— Ne jemi të tepërt. Brigada e Skraparit u nis. Nuk dimë në do të na pranojnë.

— A do t'i arrijmë në rrugë? — pyeti tjetri. Shoferi e shkeli gazin, po nuk i arriti. Ata zbritën në Lushnjë.

— Të faleminderit, vëlla!

Ata u përshëndetën. Shoferi iku. Dy shokët shkuan në Shtabin qendor. Në orët e vona të mbasditës, ata të dy arriten në Zhamë, ku kish zënë vend brigada «Ferit Leshja».

— Erdhëm dhe ne, shokë, të punojmë me ju.

— Mirë se erdhët!

Brigada u mblodh, dëgjoi dy shokët e ardhur. Ata thanë se kishin ardhur të punonin së bashku.

- Muarët leje nga qendra e punës?

— Po. Dhe nga Shtabi qendror.

Çdo gjë u verifikua. Brigada vendosi të cak-tojë njërin komandant të saj dhe tjetrin zëven-dëskomandant.

— Shokë, ne nuk erdhëm për këtë.

— Këtë kërkojmë ne.

— Dhe nesër, së bashku, të shkrihem i në punë.

— Atje do të provohemi.

Një qeshi:

— Mirë ua bëtë!

Brigada u nda në dy grupe dhe do të punon-
te në dy turne. Sektori i punës ishte i vështirë.
Ata vendosën të mos jepeshin.

Ndërtohet një urë aty, te traseja e zhavorimit, në Rrogozhinë. Ajo quhet «Ura mbikalim», Ditët e para thelluan gropën për të hedhur betonin e këmbzës së urës. Sa më tepër thellohej gropat, aq më tepër shtohej puna e tyre.

Kalojnë maqina. Shoferët e udhëtarët i shohin, i përshëndesin e pastaj largohen. Po ata vazhdojnë punën, pa ju marrë mendja nga lavdërimet: disa transportojnë zhavorin, cimenton, betoniera e gatuan, pastaj... ngarkojnë betonin, e hedhin me zhurmë në gropë, tek ngrihet këmbza e urës. Aty të tjerë e marrin dhe e shpërndajnë. Në fund të asaj: groove, në ditët e para vullnetarët dukeshin më të vegjël. Po këmbza e urës erdh e u rrit nga dita në ditë, u rritën dhe ata në sytë e kureshtarëve së bashku me punën.. Do të vijë dita, që ata do të ngrihen më lart se një urë e zakonshme.

Vullnetarët nuk flasin për vete. Ja tek afro-

het dikush. Punonjës i hekurudhës është ai, po s'ka të bëjë me ndërtimin e urës, dhe nxiton të shpjegojë.

— Shkruaj për ta, punojnë shumë mirë, pa fjalë e bujë.

Kaq thotë ai dhe largohet në punën e vet. Ti vështron Selaminë nga Strancei, Trëndelinën nga Kakosi, Ahmetin nga Çepani, Selvinë nga Prishta dhe vë re se ka raste që atyre nuk u del koha të fshijnë djersët: ritmi i punës nuk duhet ndërprerë, se në betonim koha është e kursyer. Pastaj ti afrohesh të vështrosh poshtë, te themelet e këmbzës së urës, ku betoni përplaset me zhurmë. Aty punojnë shumë vajza: shpërndajnë shpejt e shpejt betonin dhe presin një hop sa të shkarohet tjetri...

Unë pyes Elmazin. Ai është nga Prishta:

— Si ju shkoi inisiativa në kooperativë?

— Shumë mirë. E përqafuan gjithë të rinjtë.

Elmazi vetë ka mësuar tri zanate: ai është marangoz, berber dhe murator. E tani e shoh tek punon e nuk do t'ja dijë lodhjes.

— S'do të jetë keq që iniziativën e Prishtës ta përqafojnë dhe vullnetarët në hekurudhë, — them unë.

— Do të jetë shumë mirë. Ne gati jemi të ndihmojmë, thuajse secili ka mësuar zanate në kooperativën tonë.

Dikush e thirri Elmazin për në punë. Ai u largua. Unë bisedoju një cast me Florien. Ajo është nga Çepani. Po ajo ka mësuar zanatin e rrabaqepses dhe të avlëmendit. Në mënyrë të veçantë, iniziativa e rinisë së kooperativës së tyre është për studimin e veprave të marksizëm-leninizmit, e dokumenteve

mentave të partisë sonë. Unë kërkova një shpjegim rreth kësaj. Dhe më suallën si shembull luftën që kanë bërë për zhdukjen e zakoneve prapanike dhe kundër paragjykimeve fetare.

— Ja, kishim një hoxhë. Kush nuk kish fëmijë, shkonte te ai. Po ne kapëm rastin që vetë djali i hoxhës nuk lindte fëmijë dhe me këtë demaskuam profkat fetare.

Pastaj ato më shpjeguan se nga ai studim nxuarën mësim se vajzat duhet të dalin nga shtëpitë. Dhe ato dualën të marrin pjesë në krasitjen e pjergullave dhe lërimin e tokës me pendë.

— Po, megjithatë, gënjejmë veten po të themi se i zhdukëm mbeturinat, — më shpjegon një vullnetar i kësaj brigade. — Ja, këtu, në hekurdhë...

Unë shënoj biseda të shkëputura gjatë punës. Shoferët e udhëtarët përshëndesin ata që punojnë në «Urën e mbikalimit».

21 shkurt 1968

FUSHA E «DJALLIT»

Eshtë një shesh malesh që quhet Fusha e Loes. Disa e quajnë dhe Fusha e Erës, se atie fryshtumë. Dikush e quajti dhe Fusha e «Djallit», ndoshta për ashpërsinë e saj: një vend midis malesh të egra, me shtresë të gurtë, që nuk sheh veç tre dynym qiell.

Aty përreth nuk ka banesa, po malësorët panë se një ditë erdhën vullnetarët dhe ngulën mbi shpinën e Fushës së «Djallit» ndërtesat e veta të përkohshme, fjetoret, mensat. Këtë e quajtën sektori numër dy i Selcës. Prej aty vullnetarët nisën dhe hapën rrugë. Rrugë malore.

E ky shesh ka veçantinë e vet. Duket si më origjinali i gjithë sektorëve, se është futur thellë në grykë mali, i lidhur vetëm me rrugë të vësh-tira, që kalojnë nëpër shkëmbinj.

Në këtë shesh, vullnetarët kanë ngritur një farë lartësie me gurë dhe këtë e kanë quajtur «podium». Prej aty çdo herë jepen rezultatet e arritura në hapjen e rrugës.

— Shokë, brigada...

Përmenden emra brigadash. Aty nuk flitet

më për plotësim norme, po kush e ka teikaluar më tepër, kush ka fituar më shumë pikë në organizimin e aktiviteteve...

2

Po a mund të quhet ajo një pistë vallzimi? Ai vend i shtruar me zall, i rrethuar me dy breza paralele drurësh, që shërbejnë si stola për t'u ulur gjatë kërcimit, i ngjan më tepër një vathi se sa një piste. Këtu brigadat e ndryshme organizojnë mbrëmjet. E bëhet pastaj një kërcim i veçantë, i ndryshëm nga të tjerët, se është kërcim që nuk përfill rregullat teknike të elegancës së pistave, një kërcim i çlirët, ku manifestohet bota e vrullshme e vullnetarëve të rivierës, të Myzeqesë apo të malësive të jugut. Ata hedhin valle mbi shpinën e Fushës së «Djallit», ku pispilloja duket e neveritshme. Hedhin valle sipas melodish të parregjistruar me nota muzikore, valle me ato rroba të punës, që mbajnë erë dinamit, të zhyera nga shkëmbinjtë, që i kanë rrokullisur nga lartësi të mëdha.

Në këtë vend vallzimi, mbas pune, lodhja dhe mundi harrohen...

— Shiko, moj vajzë, do ta merrni veten në qafë, do të shëmbeni ndonjë ditë nga shkëmbi, se nuk i afrohet aq shumë buzës së rrugës ku punoni.

— Më fal, mos ke mbeturina?

— Unë?!

— Po, po, ti. Do t'i them komandantit të vish në skuadrën tonë, se ke nevojë të edukohesh, aty

në shkëmbin më të rrezikshëm. Në vend që të na përgëzosh...

Fillon pastaj një vesë shiu. Po dhe në atë vesë shiu vullnetarët kërcejnë mbi shpinën e Fushës së «Djallit».

Në shërbim të postërojes është një vajzë. Ajo ka mbetur e vetme me pushkën. Nga «pista» dëgjohet melodia dhe gazi i vullnetarëve.

3

— Shoku komandant, simbas urdhërit tuaj paraqitet...

Dhe përpara tij duket një vajzë që nderon ushtarakisht.

— Nuk nderohet ashtu, prapsahu!

— Shoku komandant!..

Ai nuk është komandant ushtarak, as ka ndonjë funksion në brigadë, po është një vullnetar i thjeshtë, që ka ardhur për të hapur rrugë në Malësi. Po duhet që vullnetarët të pregetiten dhe ushtarakisht. U thanë se njeri të veçantë, që të merrej kryesisht me drejtimin e punës ushtarake, nuk kishte, prandaj çdo gjë të përballohej me forcat e brigadës...

— Me leje, shokë? Kam qenë unë në ushtri, sa jam liruar, — tha njëri.

— Pastaj?

— Do t'ju mësoj unë si përdoret pushka, si qëllohen armiku...

— Dhe unë e kam kryer ushtrinë.

— Dhe unë...

— Hajde, pra, të mësojmë së bashku.

— Me leje, shoku komandant! — tha një.

Të tjerët qeshën, po veç atij, ushtarit të liruar, i mbeti emri komandant dhe u caktua nga masa vullnetare komandant ushtarak i një brigade.

Dhe brigadat e tjera kanë komandantët e zgjedhur. Detyra e tyre është e rëndësishme, po aq e rëndësishme, sa është dhe ajo e komandantit të brigadës për organizimin e punës. Ai përgjigjet për preqatitjen ushtarake në mënyrë që, pranë qysqisë e varesë aty, ndër male, mbi shpinën e Fushës së «Djallit» të qëndrojë dhe pushka.

Komandanti shpjegon:

— Armiku ndodhet...

Ata shpesh herë fjalën «armiku» e zëvendësojnë me «imperializmi», «revizionizmi».

Vullnetarët preqatiten në mënyrë të gjith-anshme për të mbrojtur atdheun dhe punën ndërtimitare.

4

Ai quhet «Shkëmbi i Rrethit të Bardhë», se është i gjithë një brez, me kilometra i gjatë, në formë harku, që bie thikë në bazën e vet, thua nga një lartësi 100 metrash. Poshtë tij është rruga këmbësore, një rrugë fort e ngushtë, ku dhe mushka e ka të vështirë kalimin.

Po vullnetarët u ngjitën majë atij shkëmbi. Aty nuk ka rrugë, po aty po hapet rrugë. Këtu e një muaj më parë aty mendohej të punohej vetëm me maqineri. Dhe urdhëri kështu ishte dhënë, po vullnetarët thanë:

— Do ta thyejmë ne.

Dhe u lidhën ata me litarë. Poshtë, nga rru-

ga këmbësore, ata ngjajnë si silueta shqiponjash që godasin me sqep mbi shkëmbinj: një nga vullnetarët mban barominën, tjetri qëllon me forcë me vare. E përplasura e varesë ndihet deri në breg të Cemit.

Një ditë aty erdhën dhe shokët e kinostudios për të xhiruar pjesë të një dokumentari nga rruga e Malësisë së Madhe.

Një çast: shkëmbi i madh shkëputet nga vendi. Kamera xhiron. Shkëmbi nuk ka kohë të zgresë deri në lumë, se thërmohet i gjithë në fund të Rrethit të Bardhë. Rrapëllima e tij shoqërohet nga brohoritje vullnetarësh.

Tek i shoh këta vullnetarë, më kujtohet biseda e një plaku të moshuar vermoshas:

— Nuk do desha jetë ma gjatë, veg sa me pa njëherë maqinën dhe dritat elektrike në Vermosh.

— Më 16 tetor, xhaxho.

— A thue?

«Shkëmbi i Rrethit të Bardhë» është vendi më i vështirë i punës: ndofta më i vështiri i gjithë turneve që kanë kaluar e do të kalojnë në këtë rrugë: ai duhet gërmuar e ulur nga masa e vet deri në 20-30 metra. Rruga automobilistike do të gjarpërojë mbi kreshta.

Aty tani punojnë vullnetarë.

5

Kur bie mbrëmja, malet hedhin hien e vet mbi qytezë të sektorit të parë. E në këtë kohë ngrihen si një shpërthim këngët vullnetare: ka çfaqje. Rugës duken dritat e ndonjë maqine të vo-

nuar, që s'ka arritur ende deri në Selcë. Këngët vullnetare e mbysin zhurmën e maqinës. Po dhe çfaqjet në sektor kanë karakteristikën e tyre vullnetare. Aty dallohen tipa të veçantë, që nuk para u bëhet vonë për rregulla të caktuara.

Eshtë një taracë e lartë. Mbi të zënë vend amatorët. Si perde shërben vetëm një batanie. Hiqet ajo dhe shfaqja fillon.

Ka lindur dhe një këngë e re në këto male. Ajo u thur disa ditë mbas botimit të letrës së plenumit të Komitetit Qendror të BRPSH, drejtuar Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshillit të Ministrave të RPSH për mbarimin e rrugës së Malësisë së Madhe më 16 tetor. Dhe kënga i uron mësuesit të rinisë, në 60-vjetorin e ditëlindjes, jetë të gjatë sa malet.

Po e bukur ndër këto male është se vullnetarët çfaqjet e tyre i japin pa u drojtur. Njëra mbaron këngën dhe thotë pa të keq:

— Kaq kisha unë, — dhe largohet.

Pastaj në skenë del të këndojojë një vajzë tjetër. E kam parë edhe herë tjetër atë. E kam parë edhe në punë, edhe kur paraqiste forcën dhe kur...

Mbrëmja ka rënë në sektor, Çfaqja artistike s'ka të mbaruar.

29 maj 1968

K T H E S A

Ngjarja ndodhi shumë thjeshtë: i ati nuk deshi ta linte në aksion dhe mbaroi. U mundua i biri, Myftari, që t'i mbushte mendjen të shkonte dhe e motra, Xhibia, me të, po s'ja doli në krye.

— Po pse, baba?

I ati e vështronë dhe i dukej çudi se si Myftari i shtronë punët kaq thjesht. Ishte në vete ai?! Apo ndoshta i binte për detyrë të fliste ashtu, si sekretar i rinisë.

— Po kush të pyet ty, more? Apo ke nge të na mbetet e pamartuar?

— Pa dale, si e mendon ti hekurudhën?

Në të tilla raste i ati zihej ngushtë.

— Kush tha, more, se unë mendoj ashtu? I harrove gojët e botës, që vetëm rastin presin? Apo do të thuash s'na bëhet vonë...

Dhe kështu vazhdonte «grindja». I ati nuk thyhej në asnjë mënyrë. Për krah ai kishte dhe vërgunas të tjera. Dhe i ati i Vezires, një shoqe e së bijës, kishte kundërshtuar, po më në fund ishte bindur. Kishte thënë se do ta shoqëronte vetë të bijën, po pastaj kishte kthyer mendje.

— Po ajo është me shoqe, mor baba! — i shpjegonte Myftari.

— Nuk le unë njeri të bëjë llogari për time bijë, more vesh? Ty të qoftë rruga e mbarë dhe na lerë rehat...

Kështu mbeti puna: shoqet shkuar dhe Xhibia, ndonëse i kish dhënë fjalën organizatës, mbeti në Vërçun.

Pas dy muajsh vullnetarët u kthyen. Me ta u kthye dhe Myftari. Ata treguan për punën dhe jetën në hekurudhë. Po sa shumë kishin ndryshuar vetë ata vullnetarë: vajzat nuk ishin më të drojtura si dikur. U muar vesh se Vezirja kishte paraqitur lutje për të hyrë në organizatën e rinisë. Qazimeja, si u kthye nga aksioni, e kish thyer heshtjen dhe kishte mbajtur përpara të gjithëve një fjalë, duke dënuar ashpër zakonet prapanike të fshatit. Dhe kjo i kishte quditur në fillim bashkë-fshatarët se deri atëhere as ja kishin dëgjuar zërin në ndonjë mbledhje. Po ja që Qazimeja e kthyer nga hekurudha fliste pa të keq dhe godiste pa frikë zakonet prapanike. Për të thanë:

— Shih, more, Qazimeja! Sikur të ketë mbaruar shkollë...

Të gjitha këto ngjarje linin gjurmë në jetën e fshatit Vërçun. Filloi në ato kohë të ketë një tjetër gjallëri. Dhe mësonin ata për beteja në punë, në jetë, në mendime.

Të gjitha këto i dëgjonte dhe i ati i Xhibies dhe heshite. Ai e shihte vetë ndryshimin e vajzave të kthyera nga aksioni e nuk i përgjigjej më të birit, Myftarit, me ato fjalë të prera. Dhe së bijës ai tanë sikur nuk ja merrte për të keq këmbënguljen për të shkuar vullnetare. Ngjarjet po zhvilloheshin ndryshtë përpara syve të tij: ish vullnetarët muarën pjesë më me guxim në punët e

fshatit, edhe mendimet e tyre ishin më të guximshme. Atij i kujtohej fare mirë se vajzat e fshatit dhe para se të shkonin në aksion, merrnin pjesë në brigadat e frutikulturës, po kryenin vetëm spërkatje. E kush kish besim te ato të kryenin punë më të holla, që kërkonin një farë mjeshtërie?! Po ja ato u ngritën me një zotim të ri për të bërë dhe ato krasitjet e shartimet:

— Po ku dini ju? — u thanë atyre.

— Do të mësojmë, — ua kthyen ato.

Dhe u ngrit rinia dhe e përkrahu mendimin e tyre. Zhaneta dhe Mukadesi drejtonin skuadra, kurse Qazimeja një brigadë. Një u nis për të kryer një kurs rrobaqepësie.

— Po ku dinë ato?! — thanë në fshat.

— Do të mësojnë! — tha rinia.

Pastaj...

Pa u organizuan dhe mbrëmje vallzimi, ashtu si në hekurudhë. Dhe në to muarën pjesë vajza. Pa u ngritën vajza të tjera dhe u regjistruan për në hekurudnë.

Një fanatik në fshat pëshpëriti.

— U prish dynjaja, i madhi Zot!

I ati i Xhibies tha:

— Bijë, nisu me shoqet në aksion!

Dhe unë tani ja tek ju them se Xibia me shoqe këtu, në hekurudhë, janë shëndoshë e mirë. Ato tani punojnë në sektorin e Gradishtës, dikush si vullnetarë e thjeshtë, dikush si skuadërkomandante, komandante apo sekretare organizate kompanie... Dhe po kryejnë këtu ato një shkollë të madhe, atë shkollë që ju tanimë e njihni nga ish vullnetarët e turneve të para. Do të kthehen ata, vullnetarët, mbas disa javësh në Vërçun e

do të vazhdojnë luftën për të renë dhe po dëgjuat që ai fanatik të pëshpërisë përsëri, thuajini atij.

— Ne do ta shembim të vjetrën, ti qaju të madhit Zot!

20 mars 1968

GËRSHETIM VALLESH, MELODISH

Në atë buzëmbrëmje të 7 shkurtit, në sheshin e rreshtimit u dëgjua një gajde. Ishte e vëtmja gajde në atë sektor. Dhe melodja e saj i joshi vullnetarët në valle: njëri nisi vallen, një tjetër e kapit për dore dhe u formua në këtë mënyrë një varg i gjatë, që sillej rrëth gajdexhiut. Aty kishte nga të gjitha anët: nga Burreli, Puka, Berati... Vargjet e valltarëve u shtuan njëri mbas tjetrit dhe ngjante sikur gjithë ai shesh hidhej në valle. Dhe gajdexhiu, ama, i binte. I binte dhe kërcente dhe ai, i vetëm, në qendër të valltarëve.

Unë shoh se këta valltarë, mbas punës, kërcenjë sa lodhen. Nuk janë mbrëmje për t'u dukur në sy të tjerëve këto, po ashtu, të lindura vetveti, papritur e pakujtuar. Dhe valltarët kërcenjë me çizme e rroba që mbajnë erë dheu. Dhe kjo është vallja më e bukur që lindi ato ditë dhe që ndryshoi pamjen e sektorit:

— Jepi, Zenel!

Gajdexhiu është një djalë i ri nga Kukësi. Duket se ka pritur gajden t'i vinte. Është fillimi i ditëve në aksion dhe grupet artistike ende nuk kanë dhënë çfaqjet e para, se merren me preqatitje.

Kjo gajde kishte ardhur në sektor mbas një

jave pune. Ishte parë se nuk shkohej pa një argëtim. Se kujt i kishte vajtur mendja dhe kishte thënë:

— Te barinjtë ka një gjajde.

Ishte fjala për te barinjtë shtegtarë, që kishin mbritur nga Grabova e Sipërme për të dimëruar bagëtitë në Çermë të Lushnjës. Atëherë ishte nisur Jorgji dhe u kishte kërkuar barinjve gjadë e vetme:

— Na duhet. Ju mbani radion me bateri, — u kishte thënë Jorgji.

— Merreni dhe radion me bateri, po ju desh...

— Ne deshëm të vinim vetë, — kishte thënë një nga barinjtë, — e kishim lënë për këtë të dielë.

— Të këndonim e të kërcenim së bashku me gjajde.

— Mos harroni, na lajmëroni po të bëhet mbrëmje.

Me Jorgjin ishte kthyer dhe Mihali, përgjegjës i blektorisë.

— Mos harro, Mihal, jepu të fala...

— Të mirë u gjeça..

Dhe gjajdja kishte ikur nga fusha, e kishte kaluar në vendin e punës, në trase. Atë ditë, udhëtarët e zakonshëm, tek shihnin vullnetarët, thoshin:

— Shihni vullnetarët!

Ishte një pamje që ndryshonte nga ditët e tjera.

Po dhe aje mbrëmje ndryshonte nga të tjera: aty u gërshtuan vullnetarë nga të gjitha brigadat e sektorit të Lushnjës.

— Ej, lere til!

Njëri shkëputet nga vallja dhe e le ta heqë

shoqja që vjen mbas tij. Dhe ajo, pa ditur se si kërcen, e heq. S'ka gjë, sot keq, nesër më mirë? Rëndësi ka se ti po udhëheq vallen, motër e vogël, e Pukës qofsh, e Gramshit apo e Burrelit. Shkëputet dhe ajo. S'ka gjë, vëlla, në kërcen me çizme llastiku! Rëndësi ka se ti kërcen mbas pune vallen e punës.

Së fundi vallja mbaron. Valltarët marrin frymë të lodhur.

— Unë s'dija, — thotë një vajzë, — po hyra në valle.

Ajo i flet ngadalë shoqes:

— E kush dinte! Ja dhe unë, për herë të parë kërcej, po dalëngadalë do mësojmë.

Unë i njoh ato dy vajza. Emrat nuk ua di, po mbaj mend se i kam takuar në fillim, kur erdhën nga Gramshi.

Pastaj nisi kënga. Këndonte me ta dhe përgjegjësi i blektorisë, Mihali. Ai do të kishte ç't'u tregonte 15 barinjve grabovianë: ish një këngë partizane ajo; bëhej fjalë si një partizan i kërkonte një fshatari t'i tregonte rrugën, që kish humbur:

«— Ça m'nep mue ta rrëfej, o partizan.

— Po të jap një ball fishek, o katundar...»

Kur pushoi gajdja dhe kënga, atëhere u dëgjuat qartë, tingëllimi i çiftelisë. Me të kërcenin valle pukjanët. Ishte valle burrërore ajo, valle guximi: tre vullnetarë, nga Iballa e Pukës, përpinqeshin të vinin në dukje, gjatë kërcimit, forcën dhe qëndrueshmërinë, kush e kush më qartë, më pre-rë, më bukur. Dhe duke sheshin ata të tre si tri shqiponja, që s'jepeshin nga lodhja.

Dikush aty pranë, duket nuk ishte nga Puka, më tregon se ata kërcejnë bukur.

— Këngën, — thotë ai, — ta thurrin aty për aty... Dhe, a e di? Për këngë janë si lebët e për valle si devollinjtë... Ja, shikoi, të vetmit!

Cudi, q'përcaktim i dha ai! Po mua kjo nuk më interesonte. Unë shoh se në këtë shesh gëreshetohen vallet, meloditë.

Ndërkohë, diku aty pranë, u dëgjua një fizarmonikë dhe një def.

— Po këto nga erdhën?

Eh, kështu e ka, melodia ndjell melodinë, gazi gazin. Kur u dëgjua gajdja, dy djem që banonin në afërsi të sektorit, muarën veglat, kapërcyen gardhin dhe erdhën e ranë midis vullnetarëve. Gjithë vëmendja tani u përqendrua te ata. Tani ndryshoi dhe vallja. Filluan të kërcenin dy nga dy, çifte djemsh. Ata nuk dinin të kërcenin mirë dhe as ishin veshur për mbrëmje. Ata ishin kthyer nga puna.

Unë pyes një vullnetar nga Berisha:

— Po ju pse s'kërceni ashtu?

— Na vjen turp. Ma vonë do të mësojmë.

Ishë mbrëmja e parë e madhe e organizuar rastësish, nën dritën e një llambe elektrike. Ajo nisi me një gjadje...

DRITARE TË MEDHA

1.

- Ku bije Krej-Lura?
— I ke dëgjue Liqejt e Lurës? Aty pranë.

Ora ka vajtur 10 e vullnetarët bëjnë pushimin e tyre të zakonshëm: dikush lan duart, dikush ha bukën që ka marrë me vete, dikush hedh lopatën e fundit të betonit, dikush... Në këto pushime gjen rast dhe të bisedosh me vullnetarët. Ata nuk bëjnë fjalë për 13 vajzat dhe 8 djemtë të ardhur nga Krej-Lura, që janë rreshtuar në kompaninë e parë të brigadës «Gjok Doçi» të Peshkopisë; për ta thonë vetëm se e plotësojnë normën deri 115 përqind. Bisedojnë vetëm për tri vajza, për ish vullnetaret e turneve të para, që u kthyen në Krej-Lurë nga fillimi i muajit qershor të vitiit të kaiuar.

— Ky ishte turni i parë prej tri vajzash, ndërsa ne të tjerët jemi turni i dytë.

Kur zbritën ato në hekurudhë, ende nuk kishin filluar në masë punët e kooperativës, ndonëse

ajo ishte formuar që në dhjetor të vitit 1966.

Ishin vetëm tri vajza që zbritën nga Krej-Lura në hekurudhë. Jeta e tyre më përpara nuk kishte asgjë me rëndësi, vazhdonte si zakonisht: u vinte rëndë të dilnin jashtë caqeve të vendlindjes, përpinqeshin të zbuluronin veshjen e tyre karakteristike, ulnin kokën ndaj bisedave të djemve, nuk pranonin të punonin së bashku me shokët, apo të hapnin livadhet e të bënин qilizmë. Njëra prej tyre quhej Sulltane.

Po ato të trija ikën nga fshati dhe zbritën në hekurudhë. Për to nuk u mësua gjë si ja kaluan kur u kthyen në fshat...

Një ditë, në fshat, banorët panë tri vajza me shaminë e vullnetarit në qafë, me fytyra të rracha nga era e të thekura nga dielli, me duar të vrara nga puna.

- Përshëndetje nga aksioni, vëllazën!
- Oho, si flasin këto, pa drojtje! Paskan ndërrue dhe veshjen: një fustan basme, një bluzë.
- Njana ende s'i paska hequn pantallonat!
- Dëgjoni, pra, se atje në hekurudhë...

Kështu filloi e reja të futej në jetë. Sulltana me shoqet e veta u bë aktiviste. Një nga një vajzat e Krej-Lurës filluan të ndërrojnë veshjen. Kishonte dhe gra të moshuara që ndërruan veshjen.

Sulltana me shoqe i dha nxit kësaj të reje. Organizata e rinisë u mblodh dhe e zgjodhi Sulltanën sekretare: ajo ishte vajzë e heshtur kur shkoi në hekurudhë, u kthye luftëtare nga hekurudha.

Si sekretare e organizatës bazë, vajza e re filloi punën për jetën e kulturuar në fshat.

- Dritaret të hapen të mëdha, të hyjë ajër,

diell, se frengjité sikur e ndrydhin njeriun brenda katër muresh.

Kështu filloi lufta e mendimeve të kundërtë, po kështu u siguria dhe fitorja. Në dritaret e mëdha filluan të vendoseshin perde të bukura. Fshati po merrte një pamje tjetër.

Pastaj vajzat e fshatit u panë ndër livadhe të punonin krahas me djemtë.

— A e din ti se puna kambëngulëse e këtyne tri vullnetareve bani që, në kët turn, të vinë në hekurudhë 13 vajza?! Desh të vinte dhe Sultana me shoqe, po i lamë atje, të punojnë sa të kthehem na.

Krej-Lura është vend i largët, po gjithë lokaliteti e mësoi historinë e tri vajzave vullnetare.

— I ke dëgjue Liqejt e Lurës? Aty pranë janë ato.

2

— Kur u kthyen nga hekurudha, ajo bani lutje për kandidate partie.

— Tani e kemi komandante brigade.

Kështu e lidhin vullnetarët e turnit të tanishëm ardhjen e tyre në aksion, si traditë të vullnetarëve të turneve të mëparshme. Dhe, në qoftë se nga lokaliteti Fushë-Lurë në turnin prill-maj të vitit të kaluar erdhën 15 vajza, tani në rreshtat e brigadës «Gjok Doçi» numërohen 110 vajza dhe 50 djem. Ka në të dy brigadat 42 kandidatë e kandidate partie, që kanë ardhur të kryejnë stazhin.

Këtu do të bëjmë fjalë për Prendën. Është nga

Katundi i Vjetër-Lurë. Dhe ajo ishte vajzë e thjeshtë, që ju përgjegj thirrjes së partisë e doli vullnetare. Se qysh shkoi në hekurudhë, nuk dinin. Gjëra të hollësishme nuk ishin dëgjuar.

Po ja që një ditë, më 15 maj të vitit të kaluar, Prenda u ndodh në konferencën e rinisë së rrëthit të Peshkopisë, ku ishte zgjedhur delegate. Atë e dëgjuan atje për herë të parë të fliste për hekurudhën, të fliste për brigadën e vet, për shoqet e veta, për mbledhjen e të reja ve vullnetare në luftë kundër zakoneve të vjetra, për punën e madhe që bëhej në hekurudhë, për rregullin e disiplinën, për vizitat në kooperativat fushore dhe qytetet e ndryshme, për aktivitet. Kjo ishte fjala e parë e saj e nxjerrë nga mësimet e jetës. Atë e dëgjuan me kureshtje. Ajo u kthyte përsëri në hekurudhë për të vazhduar turnin...

Turni mbaroi. Prenda u kthyte në Katund të Vjetër. Tani për të filloi një jetë tjetër,jeta përtë ecur përpara. Dhe ajo e kishte kuptuar qartë se mendimi i ri nuk fiton asnjëherë me drojtje e heshtje.

Në fshat u hap lajmi se brigadierja Prenda ka bërë lutje për në parti.

— Kush, Prenda? Pse, u ba brigadiere?!

— Po, po. Ajo që ka qenë njëherë vullnetare.

Prendën e njihnin. E njihte brigada që drejtonte. Dhe të tjerët e njihnin, e secilit ju bë qejfi.

1 prill 1968. Brigada «Gjok Doci», që do të nisej në aksion, ishte grumbulluar në Fushë-Lurë. Ishin shumë. Vetëm 150 veta u caktuan për atë turn.

Prenda po nisej për të dytën herë në hekurudhë. U zgjodh komiteti i rinisë së brigadës dhe sekretare e tij u caktua Prenda.

— Po ju ku e njihni? — pyeta unë.

— E patëm ndigjue sa herë. Brigada e saj në Katund të Vjetër asht ndër ma të mirat në lokalitet e shquhet për punë të organizueme...

Kandidatja e partisë, komandantja e re e brigadës vullnetare «Gjok Doçi» është vajzë e thjeshtë, e dashur. Ajo nuk ka turne pune të caktuara, punon në çdo turn dhe gjendet kudo për organizimin e punës.

— Dhe brigada jonë ka marrë flamurin, — thekson njëri, — flamurin e sektorit që në ditët e para.

Duke bërë fjalë për kandidatët e partisë që zbritën nga malet së bashku me brigadën, vullnetarët tregojnë se ata gëzojnë respektin e madh dhe nën shembullin e tyre shkon e gjithë brigada.

3

— Ajo asht organizatorja ma e mirë në fshat.

— Qe e para...

Vullnetarët nuk mohojnë që në ato anë ka dhe fanatizëm. Po ardhjen në hekurudhë e quajnë dhe një vazhdimësi të punës këmbëngulëse që kanë bërë vetë të rejas për të vënë në jetë normat e reja të moralit komunist. Ndofta tanë ato nuk bëjnë aq përshtypje se fshati po mësohet me zakone të reja, po në fillim dukeshin si të paprangueshme.

Dhe ata bëjnë fjalë për Natashën. Ajo është nga Gjur-Reçi. Erdhi në hekurudhë së bashku me 9 shoqe dhe dy shokë. Punon si vullnetare e thjeshtë.

Nuk qe e rastit që Natasha ju përgjegj ndër të parat thirrjes së partisë pér të shkuar në ak-sion. Ishte koha kur në fshatrat e malësisë quhej pér turp që vajza të punonte në zyrë me «burrat». Po Natasha e shkeli këtë turp dhe u fut në zy-rën e llogarisë, duke kryer detyrën e arkëtares. Ndofta pati dhe gojë që përfolën veprimin e saj në ato kohë, po gojët u lodhën dhe heshtën, se Natasha detyrën e vet po e kryente më së miri...

Lindi vonë një mendim i ri dhe u pa e arësyeshme që dhe punonjësit e administratës, pér t'u lidhur më mirë me masat, të merrnin pjesë drejt-përsëdrejti në punë prodhuese. Natasha qe ndër të parat që e përkrahu këtë mendim dhe nuk cak-toi ditë pune, po, krahas detyrës së vet si arkë-tare, merrte pjesë çdo herë në punët bujqësore. Kjo e rriti më shumë figurën e saj në fshat dhe bëri që ta dëgjojnë e të merrnin shembull ngajeta e saj, ndonëse «nuk ishte burrë» dhe ishte në moshë të re.

Natasha po ecte në jetë. Shoqet e saj po ja përkrahnin mendimet, se shihnin te ajo një nga luftëtarët e së resë.

Ndodhi njëherë që ajo nuk doli në fshat me veshjen e zakonshme.

Dhe banorët u çuditën se si e gjeti ajo atë gu-xim e vendosi përnjëherë. Ata nuk e dinin se ai guxim kishte fjetur në thellësi të saj, si te shoqet e tjera, dhe, kur gjeti rastin, shpërtheu jashtë. Lufta që kish filluar pér ndërrimin e veshjes së rëndë, më në fund mori rrugë. Lajmëtarja e parë qe Natasha.

Organizata e rinisë e lavdëroi pér këtë ndërmarrje dhe e solli si shembull të luftëtares ndër të gjithë anëtarët e saj. Kaq duhej: brenda dy ditëve

dhe vajzat e nuset e reja ndoqën shembullin e Natasha-s.

— Këtë as e prisnim, po tani në kooperativën tonë të gjitha gratë kanë ndërrue veshjen.

— Dhe kjo u ba aq shpejt, thue sikur të kishin pritë veç Natasha... .

Tani Natasha ndodhet në hekurudhë. Ajo zbri-
ti nga Gjur-Reçi për të marrë mësimë të reja e së
bashku me shoqet e veta t'i vëre në jetë.

4

Ai na ndërpreu bisedën me të qeshur:

— Ke pa ti?! Po u hapen sytë grave.

Janë disa çifte që kanë ardhur në hekurudhë, Kjo s'ka ndonjë të keqe e, në disa raste, ka të mi-
rat e veta, sepse thyen ndonjë mendim të vjetër.
Pastaj vetëjeta e aksionit i bën këta të krijojnë dhe
sjelljet e reja në jetë e shoqëri. Kështu, kur të kthe-
het nga aksioni, burrit nuk do t'i bëjë përshtypje
në qoftë se gruaja do të marrë pjesë në prodhim,
pa qënë vetë ai, «burri» kujdestar i saj, se këtu
punojnë të gjithë së bashku, e ndonjëherë jo në
të njëjtin front. Këtu dalëngadalë vullnetarët më-
sohen me jetën kolektive, duke organizuar aktivi-
tete të përbashkëta, pa çka në janë dhe nga
fshatra të ndryshëm.

Vullnetarët më shpjegojnë se në hekurudhë
nuk vihet re ndarja e punës, ashtu si është zakoni
në Malësi, «punë për burra e punë për gra», se
edhe ato janë në gjendje të bëjnë beton si burrat.

— Ja, në shpërndarje të betonit, aty brenda

në armaturë, punon Avdia, Mexhiti, Tonja dhe Meremja...

Në fronte të tjera punojnë krahas shokëve, të tjera vajza e gra. Së bashku ata ngrinin një urë. Dhe punë të tilla i mësuan t'i kryejnë duke përfituar nga mjeshtëria e shokëve të vet, si Hasani apo Mexhiti, që më parë ishin marrë me kësò punimesh në ndërmarrje të ndryshme. Sidoqoftë, mendimi i ndarjes së punës po thyhej nga dita në ditë.

Edhe nga çasti në çast krijueshin sjellje të reja te vetë vullnetarët. Ndodhi që bisedën tonë njëherë e ndërpree me të qeshur Xheladini.

— Ke pa ti?! Po u hapen sytë grave. Arritën të mësojnë dhe ato punë të reja që në ditët e para të aksionit.

Fjala ishte për të shoqen e Dine Buçit. Ishte ulur ai si çdo herë, në pushimin e orës 10 të hante bukë sëbashku me të tjerët. Dhe kish kërkuar si çdo ditë që ajo të ngruhej e t'i sillte ujë se i pihej. Po ndërmjet tyre ishte zhvilluar kjo bisedë:

- Punon ti?
- Po! — ish përgjigjur Dineja.
- Po unë?
- Dhe ti punon.
- Po ujë pse s'pi vetë?

Dineja qeshi. Dhe të tjerët qeshën me «burrërinë» e Dines, duke harruar se që nga ai çast humbi dhe «burrëria e tyre».

LUFTË ME QIELLIN DHE ME BALTËN

Moti gdhiu me shi. Po është zakon ndër vullnetarët që, kur moti gdhin me shi, ata marrin veglat dhe nisen në punë, se tanimë ja kanë mësuar hilet atij: ndodh që shiu s'mban shumë e koha hapet. Përkundrazi, kur nuk mund të punohet në trase, ata presin dhe, pastaj largohen me mendimin se punën e asaj dite do ta kryejnë më vonë.

Kështu ajo ditë gdhiu me shi: qielli kish gjëmimë, vullnetarët këndonin këngë partizane. Unës brigadat vullnetare të Peshkopisë, të Pogradecit dhe të Gjirokastrës. Secila zuri vendin e vet të punës.

— Dhe pastaj? — pyes unë.

— Hë, pastaj shiu s'do të pushojë. Ne punojmë. Balta e Myzeqesë është e mbërapshtë, se ngjit. E në të tilla raste traseja nuk e pranon atë baltë. Ne presim.

— E fundi, ç'përfituat?

— Hë, ç'përfituan? Ti nuk mund ta kuptosh, or mik, se, po të na thoshin në shtëpitë tona se po vjen uji e mund të dëmtojë, mund të kishte dhe nga ata që do të delnin me përtesë... Po ne këtu, si e sheh, luftojmë me qielin, me baltën, me veten tonë, rrëshqasim e thyejmë turinjtë. E përse gjithë

thë kjo? Veç për disa karroca dhe që i shtojmë trasesë.

Dhe është e çuditshme se vullnetarët këto mbajnë më shumë mend. Ata nuk të përmendin ditët e zakonshme, kur qdo gjë shkon më së miri e norma tejkalohet, po të përmendin pikërisht ato çaste kur norma nuk është realizuar e s'hyjnë në llogaritë e ditëve të realizimit të grafikut të punimeve në hekurudhë. Po ja që dhe këto ruajtkan në vete vete diçka madhështore. Dhe kjo përbën romantikën e të rinxhë vullnetarë në punë.

Qielli derdhte shi, balta ngjiste, çizmet e llistikut rrëshqisnin, vullnetarët mundoheshin të hidhnin një karrocë dhe më tepër në trase.

Aty nga ora 12, ata u kthyen në sektor.

Shiu binte më nge.

Ishin të lodhur dhe kishin zënë vend në fjetore. Secili tregonë historinë e vet dhe të shokut. Histori e zakonshme: një rrëshqitje, një turi gjithë baltë.

Dhe pastaj qeshnin me shiun, me baltën, me veten, sikur donin të tregonin «dobësinë» e vendosmërisë së tyre.

Dera e fjetores u hap. Një s'kishte mbaruar ende së qeshuri, tjetri...

— Shokë!... — tha i porsaardhuri.

— Po kush ishte ai? — pyes unë.

— Ku ta dimë ne, tekniku, apo inxhinieri, po dimë që e quajnë Niko dhe e kemi si përgjegjës të punimeve.

Ai shpjegon se mbi urën e rrugës kryesore duheshin shtruar patjetër shinat, në mënyrë që të lidhej traseja e treni të kalonte lirisht për zha-

vorimin e saj deri në thellësi, në afërsi të kodrës së Shëngjergjit.

Se si u përbys ai gaz, askush nuk e mori vesh. Të rinjtë u bënë të vëmendshëm.

Binte shi.

— Si thoni, shokë?

— Gati jemi!

Ora ishte 13,30. Dreka desh edhe dy orë të gatitej.

— Të përfitojmë kohë, se erret shpejt e, po na u desht, nuk do të shohim të sharrojmë shinat.

— Gati jemi!

— Mund të qëndroni vonë, pa drekë.

— Gati jemi!

Bie shi. Përmes sektorit çan një kompani e brigadës së dytë «Agron Elezi.» Ajo këndon «Bashkoniu shokë...» Ndër duar ata kanë darë për të ngritur shinat peshë. Dhe shinat janë të rënda e të gjata. Thonë se një peshon 18 kv. E këtë e ngrenë 18 veta peshë, në një largësi prej 300-400 metra nga vendi i nisjes. Është baltë, baltë e Myzeqesë; është ngjiti, e duhet të ecësh me kujdes, se edhe rrëshqet.

Ruga kryesore është larg. Sa të dalësh në të, se pastaj shinat, të kapura në darë të hekurta, mund t'i shtysh rrëshqanthi.

— Forcaaa!

Ëhë, s'ka «forca»: këmba e zhytur në baltë nuk del prej andej; Përplase, po deshe, kokën mbas shinës, zhytu deri në brez në baltë dhe përsëri ato aty kanë për të mbetur.

— T'i lutemi traktoristik që është te grumbullimi i zhavorit, ai do të na japë një ndihmë, sa të na i nxjerrë në rrugën kryesore.

— Do t'i duhet atij të punojë më vonë; për hatrin tonë. Ai ka plan.

— Le të punojë! Dhe ai revolucionar është.

— Nisu!

Një niset.

Bie shi. Një traktor nxjerr tē parën shinë në xhade. Ai kthehet tē marrë tjetrën. Tetëmbëdhjetë vullnetarë mbërthejnë shinën ndër darë dhe e shtyjnë.

— Forcaaa!

— Nuk punon dara ime shokë, rrëshqet si djalli! Hidhe tej e kape me duar!

Bie shi. Duar tē forta kapin shina tē lagura, tē hekurta.

Të tjerë vullnetarë i presin atje shinat për t'i vënë në vendin e tyre, ndërsa ata tē tetëmbëdhjetë nisen rishtazi tē marrin tjetrën.

Bie shi. 18 shina zënë vend.

Në atë kohë, kur shokët mbarojnë së ngrëni drekë, në sektor dëgjohet përsëri kënga «Bashkoniu shokë...».

Të nesërmen treni kalon lirisht në gjithë trase-në e shtruar.

...

...

...

...

...

NGJARJE NË RRUGË

Nata kishte rënë. Atje, te zhavorimi, afër Rrogoszhinës, ishin ndezur dritat elektrike. Punohej me turne deri vonë. Maqinat s'i linin radhë njëra tjetrës. Shoferët prisni shkarkimin. Vullnetarët shpejtonin lopatat. Zhavori zbriste me zhurmë nga karroceritë. Dikush shénonte targat e maqinave. Koha nuk priste. Bënte ftohtë.

1

— Stefan, o Stefan! Si do t'ja bëjmë, more vëlla, vendi i kalimit është i ngushtë. Ku është buldozeri?

— Buldozeri?

Stefani nuk është i ri. Ai i ka mbushur të 36 vjetët dhe ka ardhur në aksion së bashku me gruan e të mbesën. Janë tre vetë nga një familje. Vetë ai, Stefani, është njeriu i gjashtë aksioneve. Si të thuash, ai u rrit me aksionet e rinisë dhe nuk mund ta kuptonte jetën jashtë tyre. Dhe që andej nga fshati Lëngëz, në ato ditë të shkurtit 1967, Stefani i shkroi komitetit të rinisë se ishte i gatshëm të merrte pjesë në hekurudhën Rrogoszhinë-Fier. Po

sa vetë çfaqën dëshirën atëhere! E gjithë Shqipëria u ngrit në këmbë të ndërtojë me vrullin rino r të ardhmen e vet. Shumë shkuan, shumë mbetën vëtëm me dëshira. Stefanit ju thye zemra: atij i erdhi një falënderim për dëshirën e çfaqur.

S'ka gjë, Stefan, të gjithë nuk do të shkojnë. Ndofta do të vijë koha...

Dhe Stefani mbeti në punën e vet, si rojtar i pyjeve.

Një natë ai u këshillua me pjesëtarët e tjerë të familjes: nënën, gruan dhe mbesën.

— Unë kam menduar të shkruaj një letër e të kërkoj të vete në aksion.

— Do të vij dhe unë me ty, — tha e shoqja, Kleanthi.

E mbesa, Leonora, tha:

— Unë jam e para, se jam e re; mbas meje ju-

— Ku ka këtu për të parë e të dytë, — tha Stefan — të gjithë po shkojnë, ndërsa ne...

Nëna tha:

— Po pse s'të pranojnë, more bir, ti e shkrove një letër!

— Nuk ka radhë, gjyshe, — tha Leonora.

Po Stefanis kishte vendosur të shkruajë letër tjetër. Dhe letra u firmos nga tre vetë. Plaka tha:

— Ishalla ju pranojnë, or bir!

Kaluan ditë. Kaluan kohë. Dhe ja aty e dy muaj më parë u muar vesh se nga rrëthi i Ersekës do të nisej për në hekurudhë një brigadë vullnetarësh. Stefanis s'kishte marrë përgjigje.

Stefanin e lajmërojnë nga komiteti i partisë:

— Bëhu gati të nisesh!

— Po unë do të marr me vete gruan dhe mbesën, ndryshe ato nuk më lënë të shkoj.

— Mirë, merri dhe ato.
Dhe të nesërmen ata u nisën.

-2-

Është e vështirë të bëhet fjalë për secilin vullnetar. Do të tregoj për natën e stuhishme te trau i urës.

Kompania e parë punonte aty. Në betonimin e traut kryesor të urës u desh që disa nga vullnetarët të ngjiteshin lart. Ishin orët e vona të natës. Frynte erë. Ata që përzjenin betonin poshtë ishin më mirë, po ata, atje lart, vajza e djem...

— Kujdes!

Është natë e stuhishmë. Era mundohet t'i shkulle që andej.

Hoho, një lopatë fluturoi tej!

Vullnetarja shpëtoi mirë. Tek e sheh një pamjetë këtillë, inxhinier Andrea urdhëron ta lerë punën e gjithë kompania, të 12 vajzat e të 16 djemtë, e të nisen.

Po ja që urdhërat e inxhinierit nganjëherë...

— Lereni punën e shkon. Nuk punohet në këtë stuhi!

— Betonimi do bërë, inxhinier. Ju e dini se në këto raste, koha nuk pret për nesër.

— Kuptoni, nuk mund të rrezikojmë për betonim.

— Secili kokën me vete e ka, inxhinier. Në mos e pastë, le të rrezikohet.

— Po merrni vesh ju, apo jo?

Hoho, fluturoi dhe një lopatë! Ajo duket shpëtoi nga duar të mpira nga të ftohtit. S'ke ç'bën,

inxhinier! Është natë e stuhishme kjo. Sigurisht, ju mendoni e kujdeseni për shëndetin e tyre, po ata e kanë mësuar përmendësh proverbin që trim është ai që mbyt një luan e jo ai që mbyt shtatë mace, se macen e mbyt edhe një fëmijë...

Ishte natë e stuhishme. Ora 10. Betonimi në traun kryesor të urës ishte kryer me sukses.

Unë pyes Stefanin në ndodhej asaj nate atje.

— Lart, në traun kryesor të urës, kisha gruan, ndërsa vetë pregatisja betonin, poshtë.

— E shkreta grua! — thashë unë me shaka.

— Pusho se të dëgjon! — tha ai.

-3-

— Sigurisht, ju tani kryeni punë në një front të vështirë. Unë shoh se duhet këmbëngulje e shpejtësi, ndryshe pengohet trafiku i zhavorimit.

Bashkëbiseduesi im tregon se s'ishin vetëm ata që kryenin punë të vështira: ishte dhe një brigadë e Gjirokastrës dhe brigada e Beratit... Ishin vetë shoferët që nuk jepeshin.

— Nuk di në keni kaluar raste të tjera vështirësie.

— Ka patur në ditët e dëborës.

Ai tregon, unë përfytyroj.

Ende ora s'ka vajtur 6. Mëngjezi nuk ka si duket më tani, se qelli është i përhimtë. Vullnetarët e brigadës së Ersekës kanë lënë shtretërit e kapanoneve e shkojnë drejt vendit të punës në trase. Sot çdo gjë matet me të ftohtit, me dëborën që bie, me thëllimin që fryn. Dhe ai i ftohtë s'të lë të përdorësh veglën e punës. Ah, çdo gjë le të

ngrinte, xhanëm, po vetëm duart jo, se ato nevojiten për punë!

Nën jakat e mushamave vetëm fryma del e ngrohtë, pastaj ajo zhduket.

Megjithatë, brigada nuk e la punën. Atyre nuk u tha kush të dilnin patjetër në punë dhe askush nuk u tha që të qëndronin deri në fund.

— Qenka si dëbora e Korçës, kjo!

Një qesh. Tjetri ka filluar punën pa pritur urdhër.

— Shokë, si thoni, fillojmë?

— Mirë, mirë, bëni llogari.

Kazma, lopata, karroca.

— Më shpejt, se nxehesh, mik, më shpejt!

Bie dëborë. Fryn thëllim. Midis të tjerëve dalojen dhe dy vajza, që duken më të vogla nga të tjerat, Liliana dhe Margarita.

— Largohu, Liljana!

— Dhe ti, Margarita.

— E pse?

— Nuk i shihni duart, ju kanë plasur.

Ato vështrojnë duart. Duart u dhëmbin. Vajzat nuk duan të largohen, po vendimi i kolektivit i detyron.

Bie dëborë. Fryn thëllim. Brigada e realizon normën 135 përqind.

Sigurisht, këto ishin pjesë të shkëputura ngajeta e një brigade. Po aktivitetet e saj gjatë dy muajve në hekurudhë qenë më të shumta. Ajo u konsiderua si një ndër brigadat më të mira.

KRENARI

Unë e pashë atë. Ishte më i vogli i brigadës. E kjo më bëri dhe të pyesja për të. Duke shfletuar tani shënimet në blok, shoh se kam harruar të shënoj emrin e tij. Ai ishte i vogli i bjeshkëve që me hapa malësori zbriti andej nga Buzmadhi dhe parakaloi fushës së Myzeqesë. Erdhi i vetëm që andej, i pashoqëruar nga ndonjë pjesëtar i familjes. Ai lidhi në qafë shaminë e vullnetarit. Veshi rrobat e aksionit dhe kapi e punoi me një karrocë. Kush e pa, qeshi në fillim, po malësori i vogël mblodhi veten. Atë pastaj shokët e panë të punojë dhe me kazmë, ndonse kazma ishte e gjatë, gati sa ai, e panë të mbushë dhe me lopatë, ndonse lopata ishte më e gjatë se ai....

Unë e pashë të kalojë pranë nesh i mbledhur me një shall e vetëm një pjesë e fytyrës i dukej. Kish një gjym në dorë dhe nxitonte.

— Po ai? A nuk është mjaft i vogël?

— Në moshë, po... Në punë jo.

Të drejtën, nuk m'u besua, po mendimin tim nuk e shfaqa.

— Korier e keni caktuar? Apo e mbani vetëm për të mbushur ujë?

Bashkëbiseduesit qeshën.

— Ka dalë katër herë sulmues — më shpje-guan ata.

Unë e ndjeva veten ngushtë. Djali i vogël ktheu kokën dhe n'a pa. Unë kërkova ta thërrisin në bisedë. Ata e thirrën, po ai iku. Iku duke ruajtur krenarinë e malësorit. Nuk kishte kohë të merrej me pëershkrimet e një gazetari.

7 shkurt 1968

SHTHURJA E GARDHIT

1.

Unë pyeta:

— Si erdhët ju këtu?

Njëra qeshi:

— Si erdhëm pyet? Na ka thanë shoku Enver,
or ti!

I kujtoj ato vajza malësore, kur zbritën për herë të parë në hekurudhë. Në sektorin e ri nuk kishte filluar puna. Ato nuk kishin parë as trenin, se rrugët i përshkuan në orë të vona. Dhe sot e kësaj dite ato nuk e kanë parë trenin, ndaj dhe përfytyrimi i tyre është i ndryshëm. Duket sikur ato vetë po ndërtojnë secila nga një tren të veçantë, ashtu si e kanë menduar ato, një tren që vërvshëllen e çan përpara si rrufe... ,

Një ditë pas mbërritjes, i pashë midis qindra vullnetarëve, të kapura dorë për dore. Dhe në aktivitete shkonin së bashku, vështronin nxënëset e shkollave, vullnetaret e ardhura nga qytetet e tjera e shtrëngonin shoqja shoqen. Ashtu, të bashkuara,

ngjanin si një gardh i thurur për të thyer çdo dall-gé të jetës së përditshme që do të përplasej me mentalitetin e malësorëve. Po, dashur padashur,jeta do t'i drejtonte në shfigje të reja.

Një ditë prej ditësh, për të kuptuar luftën që kanë bërë për të ardhur në hekurudhë, pyeta një grup vajzash të Pukës:

— Si erdhët ju këtu?

Njëra qeshi:

— Si erdhëm pyet? Na ka thanë shoku Enver, or ti!

— Po, besa! — thanë të tjerat dhe më ngulën vështrimin në sy.

Ato ishin luftëtare.

2

— A mos ju caktuan për bashkëpunim, që u lidhët në miqësi me brigadën «Myslim Keta»?

— Jo Ishalla! Shoqet e Tiranës i kena motra.

Ndokush mund të kujtojë se këtu, në punë të përbashkët, çdo gjë ndryshon vetveti: mjafton të vish në hekurudhë dhe i ke hedhur tej mbeturinat.

Po këtu zhvillohet një luftë e madhe, e reja çan me vështirësi, se nuk ke të bësh me mendimet e njërit, po të një grupei vullnetarësh, që kanë sjeillë me vete karakteristikat e psikologjinë e krahinës. Pikërisht kjo psikologji e krijoit atë gardh, që i bëri pukjanet të kapen mirë dorë për dore. Dikush, pa takt, hedh një fjalë për t'u ndryshuar veshja. Dhe ato fjalën e pakontrolluar e kundër-

shtojnë me zgjuarësinë e malësore. Dhe ngjan sikur e kanë lënë në harresë atë çka ti bisedon, po, në të vërtetë, dhe atyre u rreh mendja po aty.

— Na nuk erdhëm kot, të tana vajza. 50 djem i kthyem që në Pukë.

Ato e dinë se këtu duhet përqafuar e reja, po mendimet i lënë në heshtje. Dhe drejtuesit e sekторit e kanë të vështirë për të prishur gardhin që malësoret kanë thurur. Ti u thua pre flokët, ato të përgjigjen se dhe qytetaret mbajnë gërshteta. Ti kërkon të ndërrojnë veshjen, ato të thonë kur të ikin. Ti u thua... dhe ato të përgjigjen se mbas tyre do të vinë dhe vajza të tjera, prandaj «të tana njëherësh nuk bahan e druejmë mos na zemërohen shoqet në katundet tonë»

Duhej gjetur një rrugë, ndryshe. Dhe këtë rrugë e gjetën vullnetaret e brigadës «Myslim Keta» të Tiranës.

— A mos ju kanë caktuar për bashkëpunim, që u lidhët në miqësi?

— Jo, ishalla! — përgjigjet Lezja. — Shoqet e Tiranës i kena motra.

Unë desha të di më tepër...

3

— Na do t'i ftojmë në mbrëmjen tonë.

— Dahet syni prej synit, me u nda na prej motrash?

— Po, ishalla! Unë Donikën e kam motër.

Dhe Lezja flet me dashuri për shoqen e saj, Donikën. Ajo e di se Donika punon në fabrikën

e tullave silikate në Tiranë. Di se Donika ka në familje...

— Ej Leze! — thërret Donika.

Dhe Lezja, së bashku me dy shoqe të tjera, afrohet. Përqafohet me Donikën dhe e kap nga flokët. Si u njohën këto, askush nuk di të tregojë. Kjo miqësi lindi vetveti që në ditët e para. Lezja ishte duke kaluar rrugës. Donika buzëqeshi, Lezja ja ktheu... filloj miqësia.

Një mbasdite, Donika ishte shtrirë në krevat. Lezja i shkoi pranë. Ajo nuk e zgjoi nga gjumi. Donte që shoqja e vet të flinte, se ndofta ishte lodhur. Pastaj...

— Po ti, Leze?

Lezja qesh me sy.

— Ke ardhur të krihesh? Ja krëhëri.

Po Lezja vështron me sy të qeshur dhe i pë- shpërit në vesh:

— Kam ardhun me më shkurtue flokët!

Shshsht! Se rregulli nuk thyhet lehtë! Asaj ju desh të mendojë shumë derisa erdhi aty. — Ajo nuk do të shkojë më të thurë gërshetin te shqet e veta.

Ikbalja njihet me tri shoqe të tjera. Edhe Shkëndija po ashtu. Të gjitha vajzat e brigadës së Tiranës janë mikesha të malësoreve. Secila ka një histori të thjeshtë...

Dilja rrëshqet e rrëzohet përtokë (kish rënë shi ato ditë e ishte baltë). Ikbalja dhe dy shoqe të Tiranës e ndihmojnë të çohet. Kështu fillon vizita nëpër fjetoret... Duket në këtë sektor sikur dy familje të mëdha këmbejnë vizita me njëratjetrën. Dhe fjalosen ato me shoqja shoqen për gjërat më të ndryshme...

Po pastaj në gërshetin e vetëm që ruajtën mjaft prej tyre, u lidh dhe një fjongo. Mos i thoni vajzës malësore të heqë atë fjongo, se e ka kujtim nga shoqja e vet vullnetare: atë ditë që lidhi fjongan, hoqi karficat dhe e pa se dukej më e hijshme.

Njëherë u thanë se do të qepin fustane basme. U qepën fustanët, po ishin të gjitha njëlloj.

Malësoret u thanë shoqeve të veta nga Tirana:

— Ne i duam si tuejat, jo të gjata deri te shputat e kambëve...

Dhe fustanet ju kthyen robaqepësisë që të shkurtohen.

Një të dielë ato i pamë së bashku në një ekskursion në sektorin e Dushkut. Kaluan mirë atë ditë dhe në darkë u kthyen me mbresa nga më të ndryshmet. Kështu e kanë ato, sa t'i zësh mikesha, pa të flasin me zemër të gjiltër: qëndrojnë bashkë, lexojnë gazetën së bashku...

Unë pyeta:

— Ju keni qenë në një mbrëmje vallzimi së bashku me shoqet e Tiranës?

— Dhe na do t'i ftojmë. Dhe ato nuk kanë për të na sha, po s'ka gajle se asht mbrëmje si në katund...

Kështu pra, ai gardhi i ditëve të para u shthur. E reja nga dita në ditë po depërtonte në radhë të malësoreve.

Unë mësova se vajzat malësore qanë kur afroi dita që do largohej brigada e të rejave punëtore të Tiranës. Dhe pyeta për këtë. Malësoret nuk kanë turp të thonë të vërtetën:

— Po, kemi qa.

— Po pse?

— Ça je tue thanë, or ti? Dahet syni prej synit, me u da na prej motrash?

— Po, besa! Mikun dona me e përcjellë deri
në shpi të vet.

— Për festë jena mikeshët në Tiranë.

Kështu filloi të shthuret ai gardh, që në fillim u duk i padepërtueshëm.

Prill 1967

MONOLOG

Ç'na përtrive vitet e hershme, moj rini, vitet e aksioneve të para! Kushdo që sheh sot vullnetarët tek zbresin në qytetin tonë të Lushnjës, kujton diçka të dhemshur, të dashur, të atyre viteve. Ishin vite të vrullshme. Apo ndofta kështu na dukej ne në rininë tonë, se ishim vullnetarët e parë, të hekurudhës së parë, Durrës-Peqin.

Ishë viti 1947. Nuk zbritëm në qytet me shallin e vullnetarit të lidhur në qafë, po me opinga të Myzeqesë. Duart tona binin erë ugari të fushave të Myzeqesë.

Ishim 140 vetë nga fshatrat dhe qyteti i Lushnjës. Të tjerë erdhën mbas nesh, po ne qemë të parët. U vendosëm në të dalë të Kavajës. Ne e kemi ndërtuar atë urën e madhe të trenit. Ej, ç'punë është bërë aty!

Ne atëhere nuk dinim orar punë. Nuk priste puna në ndërtimin e urës. Fillonte një turn, tjetri ishte i gatshëm. Po ndodhin shpesh të papritura. Në mes të natës, vinte komandanti i brigadës dhe na zgjonte me kujdes:

— Dëgjon, Llazar?

Unë isha komandant kompanie. Shokët, besoj, më kujtojnë: jam Llazar Petrua.

— Ç'ka ndodhur?!

— Duhen përsëri forca vullnetare. Shokët nuk po ja dalin.

Dhe kështu zgjonin njëri-tjetrin. E dinim që puna në ndërtimin e urës ishte delikate. Në natën e thellë dilnim nga kapanonet e fjetjes, merrnim veglat e punës, si ushtarët armët, dhe u shkonim në ndihmë shokëve. Atyre u përtëri heshin forcat (këtë e kishim provuar në veten tonë, kur na vinnin në ndihmë të tjerët).

Kur pyeti njëherë komandanti i brigadës se kush ishte i gatshëm të shkonte përsëri në turnin e tretë për të ndihmuar, ne dualëm të gjithë.

Shokëve u kujtohet. Keq e kishim me flamurin e sektorit. Na e merrte ndonjëherë brigada e Vlorës, që punonte krah nesh. Eh, ç'ndodhë atëhere! E kush nuk thërriste e nuk betohej se nderin do ta vinim në vend? Dhe, pas dy ditësh, mbas një pune të pandërprerë, flamuri kthehej në duart tona.

Ç'na kujton kjo rini e viteve të hershme! Kanë kaluar njëzet vjet që nga ajo kohë, po ne nuk harrojmë vullnetarët që preqatisnin betonin... Betoni t'i ngrin këmbët. Ne ishim të veshur me opinga. Pati nga ata që ju bënë këmbët gjak, po punën s'e lëshuan asnjëherë. Aty donin të mbeteshin. Ishte nderi i vullnetarit. Më kujtohet se, kur na prunë më vonë këpucë me qafa, nuk i mbathnim dot. Dhe fajin e kishte betoni dhe jo se ishim mësuar me opinga.

Para pak ditësh vajta në qytetin e tanishëm të vullnetarëve të hekurudhës Rrogozhinë-Fier. Pashë fjetoret me dyshekë e çarçafë. Aty më ra ndërmend se ne flinim në disa baraka dérrasash,

të gjithë në një vend, e poshtë kishim shtruar vetëm rrogoza. Atëhere ne rronim me ndihmat që mblidheshin në popull, për ndërtimin e hekurudhës.

Aty ka sallë çfaqjeje, kurse ne atëhere mbrëmjet i organizonim rreth një zjarri të madh: orkestra jonë përbëhej nga një bidon, të cilat i binte Jonuz Jeshili, ish vullnetar nga Gërrmenjçoku i Lushnjës (sot ai është brigadier) dhe nga një violinë. Dhe mbeti qysh atëhere, ndërmjet vullneta-rëve, si një gjë e vyer «bidoni i Jonuz Jeshilit». Dhe, kur shkuam në hekurudhën Durrës-Tiranë, Jonuzi, me veglën e vet, s'na u nda, ndërsa brigada fqinjë e Gjirokastrës na ndihmonte me orkestrën.

Ato vite ne i mbajmë mend, se janë vite të rinisë sonë, pjesë e jetës sonë. Ato aksione na mbrujtën, na kalitën. Shumë nga shokët tanë në aksione u pranuan edhe në parti. Kështu ishte: njerëzit provoheshin në punë. Dhe ata ruajnë në kujtimet e tyre ditën e madhe, e shënojnë në autobiografi: «në parti u pranova në aksionin e rinisë...»

3 shkurt 1967

BUZË LIQENIT

Mirëmëngjez Vjollcë! Ti mos u çudit në të drejtëhem në këtë mënyrë, ndonëse ne të dy nuk njihemi. Mund dhe të mos jemi parë kurrë ndonjëherë, po kjo s'ka të bëjë: ti ishe vullnetare në një nga turnet e para të hekurudhës së rinisë Rrogozhinë-Fier, e mua shpesh herë më pati rënë rasti të viaj në sektorin tënd. Atëhere nuk mësova asgjë për ty. Ti u ktheve në fshatin tënd, të tjerë vullnetarë erdhën... Unë ndodhem midis vullnetarësh pogradecarë, që kanë zënë vend në Gradi-shtë dhe ata më tregojnë për ty.

Më fal, Vjollcë, në s'do të arrij të përshkruaj në tregimin tim, aq sa duhet, për t'u paraqitur të tjerëve botën tënde.

Hajde, pra, fillojmë?

Mirëmëngjez Vjollcë.

Lini është ngritur buzë liqenit. Era e liqenit sjell freski.

Aty u linde ti. Aty fillove të hedhësh hapat e para, buzë liqenit.

Ti nuk e mban mend se para disa vitesh në shtëpinë tënde pati një gjëzim: të fejuan me një djalë «të ri», dy vjet më të vogël. Oho, ti ishe më e madhe nga ai!

Pastaj, duke kaluar koha, hodhe shtat. Megjithëse e vogël, ti duhej të silleshe si e fejuar.

Ti e njohe atë: ishe më e madhe se ai edhe në mendimet e tua.

Prandaj ti një ditë, duke u ruajtur nga fanatikët, u pëshpërte në vesh shoqeve:

— Unë nuk e dua.

— Ua, moj e zezë!

Dhe pastaj druajtja ju pështolli të gjithave, thua se do të fryhej liqeni dhe do të përbyrte çdo gjë, po të guxonit....

Pastaj ti u nise vullnetare me shoqe. Aty nuk the as gjysmë fjale për vete dhe shoqet nuk thanë. Ti vetëm pe se ç'ndodhë aty. Përpara syve të kaluan kuvende vajzash, ku malësoret ngrihen kundër padrejtësive të fejesave, kundër mendimeve që poshtëronin gruan dhe e kishin bërë atë një plaçkë tregu, kundër... Ti aty mësove se si e vjetra mbeti qesharake ndaj mendimeve të reja që çanin me forcë, nëpërmjet fjalës e mendimit të këtyre kuvendeve. More pjesë shpirtërisht në to, po përsëri heshte.

— E, Vjollcë, si thua?

— Ua, ç'po ndodhin gjithë këto përbrysje!

Po ti vazhdoje punën, si çdo herë, me një karro e lopatë, dhe thua se e kishe harruar jetën tënde.

Dhe pastaj u ktheve në Linin e bukur. Nuk ishe e vetme, ishe me shoqet që kishin qenë në hekurudhë. Aty ju treguat për jetën e aksionit...

Ju kujtohet ç'u tha në organizatë të rinisë? «Me ndihmën e arësimtarëve dhe të vullnetarëve, ne do të luftojmë për t'ua bërë të qartë të gjithëve rolin edukues që ka aksioni...»

Të kujtohet? Pastaj filloi lufta që të merrnin pjesë sa më shumë vajza në aktivitetet e organizatës së rinisë. Dhe qenë vullnetaret e kthyera nga aksioni, që u paraqitën të parat në festivalin folkloristik të rrethit, duke thyer kështu mendimet e çuditshme të fanatikëve. Ju e vazhduat më tej lutfët kundër mendimeve dhelparake të atyre që me fjalë përkrahnin të renë, po të afërmët e veta nuk i lejojnë në aktivitetet shoqërore, ndonëse dhe ato kanë dëshirë të marrin pjesë në jetën e gjallë të organizatës. Po lufta kundër martesës me pajë? ..

Shumë raste mund të renditnim këtu, Vjollcë, po në jetën tënde filloi një histori tjetër: ishte vazhdimi i asaj historie të hershme që ti ua pëshpërisje dikur shoqeve në vesh. Po ja që erdhi dita dhe ti ua the pa drojtje njerëzve të familjes.

— Unë nuk e dua!

— Uh, budallaqja! ..

Pastaj fillove luftë me mendimet e vëllezërve të tu, që nuk mund të duronin dot turpin. Dhe nuk u tërhoqë dhe fitove, se ishe luftëtarja e re, e kalitur me mësimet e partisë në aksionin e madh të rinisë.

Kështu ka qenë, Vjollcë?

Mirëmëngjez!

Kështu dua të të përshëndes ty gjithmonë, se kështu të pëfytyroj nga tregimet e të tjerëve: luftëtarë të jetës së re.

MIRDITORET

1

— Jo, o shokë, për të gjallë...

Kur zbritën nga Rrësheni, zunë vend në sektorin e Fierit. Ato ditët e para sikur u hutuan ca: këndeje nuk kishte male, po vetëm fushë e vështrimi të humbiste tej, në paanësi. Dhe qyteti ishte i hapur. Dhe ju duk atyre sikur zbuluan një botë të re, pa male, një botë që kërkonte rregulla e sjellje të tjera. Ndaj ato thanë:

— Na mësoni si duhet të bajmë.

Kaq qe fjala e tyre dhe kjo qe fjalë malësorësh.

Ndër njëqind vullnetarë të brigadës «Selman Cara» të Mirditës, pjesa më e madhe qenë vajza. Kushdo kujton se mendimi i ri mund të hyjë me vështirësi në jetën e tyre e për këtë ai mund t'i përfytyrojë të drojtura. Këtë përshtypje kisha dhe unë, ndofta nga ishvullnetarët e turneve të kaluara, që patën ardhur në hekurudhë. Dhe pyeta:

— Si shkon Mirdita?

— E kemi krenarinë e sektorit.

— ?!

Dhe ja si qëndron puna.

Që në ditën e parë brigada ndau detyrat e veta. Dhe ajo zuri një vend të punojë në trase. Në fillim sikur s'po shkonte puna mirë, po pastaj vullnetarët u mësuan dhe vunë një rregull.

Një gërmon, tjetri ngarkon. Karrocat kalojnë njëra pas tjetës e zbrazen në trase, ku dheu ngjishet me tokmakë. Kjo është një pamje e zakonshme e çdo brigade, veç kjo brigadë e Mirditës ndryshon nga të tjerat, se ka një organizim të **veçantë**, të heshtur e të vetëdijshëm. Këtu nuk ka njeri të caktuar të ngutë të tjerët për punë, apo t'i ftojë në garë. Secili e di punën dhe punon.

Të gjithë veprojnë si një trup i vetëm. Dhe askush nuk pret lëvdata se kishte frontin më të vështirë të punës.

Dhe është e çuditshme që këta njerëz të shtruar janë të **papërbajtur në çaste** gjëzimi. Brohorasin dhe i gjëzohen njëri tjedrit si të vegjël, tek dëgjojnë **fjalën e komandantes**:

— Flamurin e merr përsëri Rrësheni, duke dorëzuar trasenë 10 ditë para afatit.

Është e 23 herë që ata marrin flamurin e sektorit.

Unë pyes:

— A thua nuk do t'ua marrin ndonjëherë flamurin?

— Jo, për të gjallë s'e lëshojmë.

Kush ishte ajo që më foli, unë nuk e njoha. Di vetëm që ishte mirditore.

— Thonë se flenë në fushë.
 — Asht ma shumë kujdesi, o shok!

Duke folur për punën, të krijohet përshtypja se mos emrin e mirë që kanë mirditoret ua solli vetëm puna në trase. Një mbasdite që ndodheshim në sektor, bëhej një mbledhje për emancipimin e të rejave e futjen e mendimit të ri në jetën e vullnetarëve. Dhe si shembull përsëri u muar kjo brigadë e Mirditës. Si e pabesueshme, me gjithatë ejani ta vizitojmë.

Fjetorja ku kanë zënë vend vajzat e Mirditës, është po aq e madhe sa fjetoret e tjera...

Kujdes, pra, hape derën: dy radhë shtretër prej dërrase, sipër tyre dyshekët e rregulluar përmrekulli. Vetëm në jetën ushtarake kam parë një rregullim të këtillë të krevatëve: dyshekët mbledhur si kuti shkrepsh; pala e çarçafit dalë mbi krye e pak më poshtë vendosur peshqiri i syve.

Unë pyes si arrijnë t'i rregullojnë kaq mirë shtretërërit.

— Për mirditoret thonë se flenë në fushë, — më shpjegon komandantja — se dhe në gjimnastikën e mëngjesit dalin të parat në rresht.

Nuk e kuptova përgjigjen e tërthortë. Një aty pranë më shpjegon:

— Asht kujdesi ma shumë, o shok!

Dhe unë mësova se ato gohen menjëherë sa bie buria e zgjimit, hapin çarcafët të ajrosen, ndërkohë që do të zhvillojnë gjimnastikën e do bëjnë pastrimin, pastaj kthehen i rregullojnë. Të gjitha veprimet thua se i kryejnë në të njëjtën

kohë, pa qenë nevoja të nxisin shoqja shoqen.

Ato kanë kujdes për zbatimin me përpikmëri të rregullit.

3

— Ju lutem, disa emra

Biseda jonë zhvillohet në një rrreth të gjerë. Thua se ka ardhur gjysma e vajzave të brigadës. Djemtë nuk dihet nga janë.

Eshtë një bisedë nga më të lirat, pa ndonjë drejtim të caktuar. I vetmi që mundohet t'u japë një farë rruge këtyre bisedimeve jam unë se më duhet të mbaj shënime.

— Ju lutem, disa emra.

Dikujt i përmendet emri, po ajo nuk flet. Të tjerat tregojnë për të, por pa u ngutur. Sa mirë e njihnin shoqja-shoqen mirditoret e ardhura në hekurudhë! Sikur të ishin nga një fshat. Po ki para-sysh se ka aty nga Livadhëza, nga Sheshaj, nga Bulqiza, nga lokaliteti i Rubikut, nga Fangu, etj, që as e kanë parë njëra tjetrën në jetë.

— Shëno: Dava Zef Koka.

Dava është mirditorja e guximshme që, kur u martua dhe erdhën e muarën nuse me duvak, mu në mes të rrugës e hoqi duvakun dhe e hodhi tej. U habitën atëhere krushqit e vazhduan rrugën me turp, se asnjeri nuk pati guximin, më parë se ajo, të thyejë një zakon të këtillë. Dhe ajo tanë ka ardhur në hekurudhë. Ajo ka dalë sulmuese dhe për vete thotë vetëm kaq:

— Unë do të dal prapë sulmuese.

— A ke marrë letër nga burri, Dave?

— E kam ushtar. Më ka dërguar letra dhe i dërgoj, po zarfin ma shkruan sekretarja e rinisë, se ka shkrim të bukur! — thotë ajo dhe ul kryet.

Unë shënoj: Mara Kodra. Kjo është nga Fangu, nënë gjashtë fëmijësh, më i vogli 3 vjeç. Për fëmijën kujdeset vajza e madhe. Dhe Mara ka një histori të ditëve të nisjes në aksion. Do të mundo-hem të paraqes me përpikmëri një bisedë të saj.

I kish thënë e bija, Gjela, kur ish kthyer nga aksioni.

— Nanë, do të shkoj prapë.

— Jo, besa, do të shkoj vetë këtë radhë.

— Po jo, moj nanë, unë jam e re.

— Pse vetëm të rintjtë duen me mësue?

Dhe kjo «grindje» ishte ndarë qetë-qetë. Këtë turn erdhi Mara, tjetrit do të vinte djali i saj, ndërsa Gjela le të priste radhën. Kur të kthehej Mara në Fang, do t'i thoshte së bijës:

— Isha skuadërkomandante dhe dola sulmuese.

Në shënimet e mia nuk mund të la pa përmendur dhe Marie Përterin, të renë nga Kodër-Rrësheni. Kur do të niseshin vullnetarët, e çoi eëma në komitetin e rinisë. Marien nuk e kishte pranuar organizaña e rinisë të shkonte në aksion, se ishte nën moshë.

— Po ti? — i thanë Maries.

Në vend të saj ishte përgjegjur e eëma:

— E kam pru me ma çue në hekurudhë, se nuk don me më ndejtë në shtëpi.

Dhe kështu u nis Maria.

Mirditoret më bënë fjalë dhe për Dave Dodën.

— Javën e tretë të martesës e plotësoi në Fier,
— tha njëra.

— U martua dhe erdhi?

— Po, po. Kështu jemi ne, s'na pengon asgja.
E përçolli i vjehri dhe kunati, se i shoqi ishte në
punë atë ditë.

Madje i kunati kishte ardhur dhe e kishte parë
dhe në sektor të hekurudhës. Ai e kishte lavdëruar
për fjalët e mira që kishte dëgjuar pér të.

Unë shënoj dhe emra të tjera: nga Tarazhi, nga
Sheshaj, apo nga zonat e thella të Mirditës.

K U D H R A

Betoni zbrazet mbi traun e urës. Është i mbrujtur me forcën e vullnetarëve. Poshtë rrjedh lumi. Mbi lumë do të kalojë treni.

Këtu, te ura, mbas kthesës së stacionit do të ndihet vërshëllima e parë e trenit.

Aty punon dhe S.

C'ka S. që është i brengosur?

— E, si shkojnë punët?

— Mirë.

S. nuk tregon të vërtetën.

S'kish disa ditë që ishte bërë mbledhja e kompanisë për **ndarjen e shenjave sulmuese**. Të gjithë kishin ardhur me gaz të papërbajtj. Secili do të kalonte në shoshën e vlerësimit: tregohet ndërgjejga e vullnetarit në punë, sjellja e tij, aktivizimi në detyrat e organizatës, zbatimi i rregullit dhe i disiplinës...

Vullnetari duhet ta kalitë ndërgjegejn në kudhren e aksionit.

— Me leje, unë propozoj S. Të gjithë e njohim: ai punon më tepër nga të gjithë dhe aktivizohet. Ju, shokë, të gjithë e keni parë se sa i papërtuar është...

Unë nuk jam i një mendje me ty, — tha T.
Nuk ishte i një mendje me të?! Pse? Të gjithë
e njihnin shokun e tyre, po ndofta ajo, që u ngrit e
kundërshtoi, do të ketë ndonjë inat vetiak...

— Pse? S. i plotëson kushtet.

— Jo, ai nuk i plotëson kushtet.

Ja si kishte ndodhur.

Një ditë para se të ndaheshin shenjat sulmuese,
ai punonte në beton. Po S. po bënte pushim.
Këtu s'do të kish asgjë të keqe, nëse nuk kishte
punë.

— Nuk është koha e pushimit S.

— E di që nuk është koha e pushimit.

— Mirë, po betoniera do të gatuajë.

— Ej, — thirri njëri, — cimento!

Komandanti i tha S:

— Duhet cimento.

— Unë nuk shkoj të marr cimento, jam cak-
tuar këtu.

Dhe u qua të punojë në beton, pa përfillur
mendimin e drejtë të shokëve.

— Ai theu urdhërin, — shpjegoi vullnetarja
që kundërshtoi, — zgjodhi punën dhe veproi simbas
kokës së vet. Pse?

U ndez kështu një diskutim. S. u vu në sho-
shën e analizës: disa mbronin, disa... Secili kishte
mendimet e veta; po u ngrit S. dhe tha:

— Më falni, shokë, unë do të mundohem që
shenjën e sulmuesit ta marr në dyjavorin tjetër...
Unë kundërshtova në dëm të punës.

Ditët kalojnë. Kompania ka besim se ai do ta
marrë shenjën e sulmuesit.

Vëzhgim

«XHAN I MAMIT — VULLNETAR»

Unë jam vullnetar në një nga aksionet verore të rinisë. Kur u nisa, prindët më dhanë me vete 100 këshilla, të cilat, gjatë një muaji, duhet t'i ruaja si vëth në vesh.

Në krye të tri-katër ditëve, kur mua ende nuk më kishte dalë gjumi (po bëja pushimin e drekës), erdhën e më zgjuan:

— Lili-Puti, po të pret mamaka.

— Dhe babaka, — qeshi një aty pranë.

Nuk e merrni me mend si u bëra unë, Lili-Puti. Megjithatë u ngrita «fët e fët!» dhe «pët e pët!» e vajta te prindët e mi.

— Paski ardhur me «Gaz!» — u çudita unë.

— Pse vetëm ne? — tha babai rëndë-rëndë.

— Pa hidh njëherë sytë përreth.

Unë hodha vështrimin në sheshin krah rrugës e, në vend të traktorëve të fermës, që kishin dalë fushës, pashë taksi e kamiona, vetura, motorëçikleta e triçikla.

— Po sot është dhe ditë pune, — thashë unë,
— si bëtë për leje?

— Gjëra që rregullohen, — tha im atë.

— Nuk u bë kiometi për një ditë, — shpjegoi

nëna dhe këshilloi babanë: ç'të duhen ty të tjerët!
Nuk shikon tët bir, por...»

— Ku e gjetët «Gazin»? — pyeta unë mbas pak. — Qenka i ri!...

— Na e dha drejtori, — tha babai hijerëndë.

— Sa shefa e drejtora vinë me veturat e zyrës!..

— Sa i bezdiss'hëm po bëhe, — tha nëna, — nuk shikon tët bir, po... .

Im atë u nxeh:

— E pse flet kështu, moj grua, unë për atë erdha.

— Nuk e sheh si është nxirë? — tha nëna. —

Do të ketë qenë i sëmurë.

— Unë jam nxirë nga dielli, nënë, — i shpjegova, — se punoj në fushë. Normën e kam realizuar. Pa shih duart!

— E sheh, — i shfryu im më babait, — nga dielli tha. Do t'i ketë rënë pika e diellit patjetër, se nuk shpjegohet ndryshe gjithë këta të nxirë.

— Jo, moj nënë! — kundërshtova unë.

— Po, po, — tha nëna, — po s'tregon ti, të njoh unë ty! — Dhe ndërkohë aio shkoi te «Gazi», nxori prej andej një tavë me petulla dhe ma dha: «Haji, bir!»

Unë mora nja dy për t'i ngrënë. Nëna ime tha:

— E sheh, burrë, sa i babëzitur është? Nuk u bëjnë petulla këtu. Të thashë t'i sillnim dhe një tenxhere, po ti... .

Në ato çaste dhe ajo e shkretë petull më ngeli në grykë.

— Nuk dua, — i thashë nënës. — Kush i ha gjithë ato?!

— I është prerë oreksi, — tha ajo. — Të thashë që të marrim me vete dhe një ilaç për fuqi, po ti, ah ti... .

Unë qesha me kujdesin e mamakës sime. Kushedi sa do kenë qeshur të tjerët me kujdesin e mamakave të veta! Tim ati s"ju durua më:

— Leri sentimentalizmat, grua, e pyete për jetën këtu, e mos u merr me gjepura.

Kaq deshi nëna dhe ja pat:

— Po pse, kaq shpejt e harrove Lilin ti? Ty gjersa u nisëm s'të hiqejet yt bir nga goja: Lili kështu e Lili ashtu... Hajt, pse nuk shkon t'i marrësh lejë. U thuaj e ka marrë malli motrën e vogël.

— Po ajo s'ka mbushur dy vjeç, moj grua!

— S'ka gjë; thuaj është shtatë vjeçë.

Ndërkohë, nja dy nga ata të estradës së vullnetarëve më thurën bejte aty për aty:

Ka një javë që s'jemi parë,
Xhan i mamit — vullnetar!

Shih si dielli të ka nxirë

Xhan o Lili, bir o bir!

Na, ha petulla, të bëjnë mirë.

— Ja këtë më bëre, — i thashë nënës. — Kush duron tani estradën! Nuk ju pritej një muaj, po m'u ngritët me petulla e zoq e pulë. Mirë që s'paski marrë dhe viç të pjekur!

— Leri ato, — tha nëna. (Babai, ndërkohë, bisedonte me komandantin e brigadës për të më marrë nja dy ditë leje) — Po ku flini? Si i kini dyshekët?

— Me kashtë, — i thashë unë nga inati.

— Bah, më rëntë pika! I thashë ditëziut, tët ati, t'i cojmë dyshekun e mirë që kemi për miqtë, po s'deshi. Ja tani. Kushedi si të janë coptuar brinjët. Ti duhet të jesh sëmurë, po nuk më tregon. Hajt, tregoi mamit, xhan...

— Nuk jam sémurë, — i thashë. — Unë them të dal sulmues dhe kjo...

— S'dëften ti, po leri ato, se të njoh unë ty. Ty të vjen turp të hash petulla e jo të thuash që je sémurë.

Rreth komandantit tim ishin grumbulluar gjithë ata prind që kërkonin lejë. Vajti dhe mami im, që ngatërrroi punë.

Komandanti qeshi dhe më pyeti si e ndjeja veten.

— Mirë, — i thashë unë, — do të dal dhe sulmues.

Dhe ai i estradës tha përsëri:

«Ka një javë që s'e kam parë!

«Lili-Putin vullnetar...»

KARROCA KOKËRROTE

Mua më ndodhi si në përrallë: kisha dëgjuar se kishte karroca e vegla të tjera pune që flisnin trasesë, po nuk e besoja.

Njëherë, çelësin zyrës, xhaketën supeve, kasketën kokës dhe u gjenda midis gropave, ku vullnetarët e turneve të para kishin gërmuar dhë për ngritjen e trasesë. Një karrocë dore kishte nxjerrë rrotën nga sipërfaqja e ujit (më falni, kokën, se karrocat e dorës, në përgjithësi, thonë, janë kokërrota).

- Mirëmëngjez!
- Mirë se të gjej kokërrotë! — i thashë.
- Mos je nga ata të shtabit të sektorit apo të shtabit të ndonjë brigade?

— Jo.

— Kokërrotë, vëlla, po punën ta kam bërë. Ndodhi që mua m'u thye një krah dhe vullnetarët më lanë këtu. Po shokët e shtabit të sektorit e të NSHN hekurudhës nuk më dhanë dorën, të më nxirrnin nga balta. Kam gjashtë muaj që marr plevit në ujë. Madje ata të Shtabit qendror tek më shohin thonë: «E, more, se karrocat kokërrota janë, s'marrin vesh nga dynjaja! Prandaj të pyeta mos je nga ata.» Më erdhi keq dhe i dhashë dorën.

Kur doli, ajo qante me lotë uji. Unë desha ta qetësoja, ajo tha:

— Më tepër për fatin e shoqeve se sa përvete. Trasesë mbetën të gjitha.

Ne u nisëm trasesë.

— Ndal! — më tha, karroca mbas 10 metra trugë. — Hiq kapelen!

Unë e hoqa.

— Një minutë heshtje për shoqen time, e shikon?

— E shoh, Paska qenë e re, e shkreta.

— Ajo ka mbaruar prandaj nuk flet.

Ne po vazhdonim rrugën. Unë e pyeta karrrocën?

— Ku e keni humbur krahun, ju lutem?

— Në shtator të vitit të kaluar, në dyluftim me një vullnetar. Po ai ishte beratas dhe ma hangri kokën qeratai (më falni, rrotën, se unë kokë s'kam), — tha ajo e turpëruar. — Dhe që atëhere mbeta në baltë. Asnjeri nuk më çoi për «mjekim».

Rugë na bëri të ndërrojmë bisedë: marangozët e saldatorët nuk i riparonin mirë karrocat, dhe shoferët, kur i shkarkonin, i hidhnin nga maqina. Kush i dëgjoi e i pa, tha: «E, more, se karroca kokërrota janë, aq ua pret!»

Ndërkohë, ne kishim arritur te një mushama e madhe, tendë traseje, si quhet, që ka shërbuer për mbrojtjen e vullnetarëve nga shiu.

— Si je? — e pyeta.

— Ikë, more burokrat! — ma pat ajo.

— Qenke llafazane, moj motër! Mirë ta kanë bërë që të kanë lënë këtu, të vësh mend e të shkurtosh llapën.

— Ç'thua, more?! Kur kam qenë e re, kush-

toja 1960 lekë tē reja. Shikomë taní, jam katan-disur gjysma.

— Ne jemi udhëtarë, moj motër, kur tē kalojë ndonjë nga ata tē shtabit apo tē drejtorisë së hekurudhës, ngreje zérin dhe thuaju se kush-toj 19.600 lekë tē vjetra, se me këto tē rejat nuk marrin vesh ata.

— Po ku janë ata?

— Kanë punë mbledhjesh pér ruajtjen e pasurisë së shtetit, — tha karroca ime kokërrötë, — po mos u bëj merak, se do tē vinë.

Ne u larguam.

— Ndal! — tha karroca.

Unë u bëra gati tē heq kapelen.

— Nuk është nevoja, se janë gjallë, — tha kokërrota.

Në një gropë tē madhe, katër traversa tē mëdha, me katër dërrasa tē mëdha, mbërthyer me dyzet gozhda tē mëdha, kishin formuar një trap tē madh.

— Si je, turispinaq?! — më talli traversa e madhe, me sa duket nga që më pa buzërrudhur.

— Si sytë e tu! — i thashë. — Ç'kërkoni në ujë?

— Ta, mban tē na nxjerrësh? Këtu jemi rehat, lundrojmhë qđo ditë, kalamajtë nuk na bien më qafë, qejf o qejf!

— Po munde, thuaju atyre tē drejtorisë e tē shtabit tē na sjellin dhe ndonjë grep pér tē zënë peshk, — thanë dërrasat. — Tralalala!

Ç'të bëja që isha mbathur, pa e dija unë si talleshin traversat e dërrasat me udhëtarët. Ama dhe unë ua hodha:

— Rrini, rrini, — u thashë, — se do tē vijë

koha që do të mbeteni për dru zjarri, moj të shkreta.

Unë me karrocën kokërrotë u larguam. Në fund të një pellgu me ujë pashë përsëri skeletin e një karroce.

— Ta heqim kapelen? — thashë.

— S'është nevoja! Më mirë hiqua veshin atyre të shtabit.

— Si jeni, o skelete karrocash? — thirra unë.

— Kemi këtu që kur mbaroi kjo urë e karburantit. Shkojnë njerëz e vijnë e ne mbetemi në batak.

— Po ti, moj fuçi, — i thashë një fuçie bitumi, palosur më dysh, mbetur aty pranë, — pse nuk i ndihmon, apo pret urdhër?

— Paske nge ti, vëlla! Ne po na del shpirti dhe ti kërkon të na japësh gjajret. Për llafe ka të tjerë, ti shiko rrugën...

E pashë keq. I thashë karrocës kokërrotë «ikim?»

Ikëm dhe e mbajtëm frymën te ura e Savrës. Pra, e plotësuam një kilometër rrugë. Atje, or mik vëllai, hyje me mend e dilje pa tru: dérrasa të hedhura mbi njëra tjetrën, karroca që prisnin radhën për riparim kushedi që kur, një elektropompë, që duket nga të ftohtët kishte veshur në qyrk ndryshku. ca hekura të madhësive të ndryshme dhe ca fuçi bitumi. Karroca kokërrotë pyeti:

— Ç'bëni ju këtu? Ura është mbaruar.

— Thonë do të na mbajnë nja 40 ditë, sa të marrim veten, — tha elektropomba.

— Pse, more, s'ikni vetë?! — thashë unë. — S'keni turp, prisni t'ju nxjerrin të tjerët?!

Ndërkohë hekurat lëvizën. Njéri tha:

— Ore, ti po tallesh me mallin e shtetit, më duket!

Hej ç'ma mblođhi keq!

— Kapeni e futeni në fuçi! — urdhëroi elektrhopompa.

Unë sakaj i hipa lart karrocës kokërrrotë dhe fryjtë.

Rrugës, e pashë që karroca ishte lodhur shumë, dhe i thashë:

— E dashur karrocë kokërrrotë! Një kilometër rrugë bëmë së bashku dhe pamë shumë gjëra. Në ka mundësi, shko ndër sektorë të tjerë, meqë ke dhe rrrotë, e shih si ruhet malli i shtetit. Këtë shërbim dua nga ti, për nderin e madh që të bëra e të nxora nga bataku.

Karroca pranoi... Kish bredhur ndër sektorë, po unë të nesërmen mora vesh se ajo ish mytur përsëri në gropë. Unë hoqa kapelen, po ata të shtabit dhe të drejtorisë më thanë:

— E, more, dhe ti! Punë e madhe për një karrocë kokërrrotë!

11 prill 1968

KUVENDIM ME MALET

— Si je, Gjokë?

Gjoka kalon rrugëve të qytezës. Ai nuk e takon më të shqen, Dranden, se druhet. Gjoka kalon te fletërrufetë dhe sheh se njëra i është drejtuar atij... Ç'ke, Gjokë, që vrenjt vetullat? Të kanë kritikuar për fanatizëm?

Gjoka merr zjarr një hop, pastaj mendohet. Kalon vetëm rrugëve të qytezës: «A mos duen me më nda këta prej Drandes?»

Dhe së fundi ai bën fletëpërgjigjen, drejtuar autorëve të fletërrufesë, që janë shokë të tij, të ardhur nga Malësia: Ajo fletërrufe që më keni vue, asht ma e vlefshme për ju.»

Po autorët e fletërrufesë nuk binden nga kjo përgjigje. Dhe atë nuk e heqin nga stenda, derisa të shtrohet në një mbledhje...

Le të dëgjojmë me radhë.

1

— Gjokë Çani asht fanatik!

Me të ardhur në hekurudhë, ai qëndroi së bashku me Dranden. Çdo mëngjez, Gjokën do ta

shihje tek priste të shoqen e shkonte së bashku me të në punë. Seç bisedonte me të në punë, nuk dihej, po e vërteta është se nuk pranonte njeri t'i afrohej pranë.

— Gjokë Çani asht fanatic! Po kështu nuk asht mirë. Këtu, në hekurudhë, jemi të tanë motra e vllazën, ndërsa Gjoka mbeti pranë Drandës!

Të nesërmen i thanë Gjokës të ndahej nga e shoqja, të punonte larg saj. Ai u habit dhe nuk pranoi.

— Ah, sa fanatic asht Gjoka, nuk do me u veçue asnjë çast nga Drandja.

Një herë, u vajti të punojë, pranë, dhe një djalë. Gjoka tha:

— Po ti?

— Kam ardhun me ju ndihmues!

— A të kërkoi kush ndihmë?

Ai u largua, po shokëve nuk u pëlqeu ky veprim.

— Gjoka asht fanatic! Ai si shumë asht dhanë mbas grues e po humb hien e burrit.

Një ditë Gjokën e caktuan të punonte te shinat. Ai shkoi, po në drekë u kthyesh e hangri drekë me Dranden.

— Pse nuk e mori bukën me vete, po u kthyesh? Kushedi ç'i shkoi në mend!

Kështu e kanë ba zakon: Drandja në mensë le shoqet e shkon e ha në tryezë me Gjokën.

— Do pyesni ju: ç'të keqe ka? Po pse me u nda shoqesh? Këtu ka motra e vllazën e nuk hanë bashkë.

Po, Gjoka është fanatic: ai rri me gruan edhe në kohë të lirë, edhe në aktivitete.

— Njëherë.. ah, po; Gjoka nuk la kërkend

me i dhanë dorën Drandes për me hypë në trenin e punës. Dhe qe gati me ba sherr me atë që do të guxonë.

Njëherë...

Drandja një ditë mungoi nga puna se ishte sëmurë. Po atë ditë mungoi dhe Gjoka.

— Ai shkoi me e que në vizitë të shoqen, se nuk kishte besim te komandantja apo te infermierja. Pastaj u pa me të në pazar... Ja ku të çon fanatizmi: të ban me humbë dhe ditën e punës.

— A nuk i kishit vërejtë? Ata rrinin çdo herë të dy dhe kjo gjë te asnjë nuk la përshtypje të kandshme.

— Përgjigju, Gjokë!

2

«Unë, Gjokë Çani, nuk jam fanatic dhe jam përkrahës i së resë. Zbrita nga malet, së bashku me Dranden, jo me e ruejtun, po me punue me të, se, po qe puna për roje, kam këtu dhe tim nip, që ka ardhun së bashku me ne. Ne s'kena veç gjashtë muej që jena martue e, për arësyen pune (unë jam punëtor në sharra e Drandja kooperativiste) kemi ndejtë së bashku jo ma gjatë se dy javë. Kështu, ne nuk e njohim njani tjetrit sa duhet. Erdhëm këtu dhe për me u njohtë ma afër.

Unë nuk jam fanatic. Unë e kuptoj, kur e lyp nevoja për me krye ndonjë punë dhe mund të na ndani, po jo me na e ba me qëllim. Unë nuk pranoj me punue kush me ne, se doja me bisedue lirshëm me Dranden. Pse i kryej punët vetë? E

thjeshtë: se nuk due me e vu në punë të randa gruen time. Për këtë qenqam fanatik? Kur ne ende nuk njihemi mirë, ju na pengoni, ndonse e dini se andej nga ne «asht marre me bisedue burri me gruen në sy të gjindjes». Atëhere pse ju vjen thartë kur na shihni që na qëndrojmë së bashku në çdo kohë? Ju më keni thanë pse e përcjell deri te kapononi i fjetjes dhe i them «natën e mirë»; pse e pres e shkoj me të çdo mëngjez në punë. Me cilin ta la atëhere kur jam vetë këtu?

Unë gabova që nuk mora lejë, po s'kam gabue që jam interesue për shëndetin e grues; mora shkresë nga mjeku dhe dola e vizitova në radioskop. Si thoni, ta lija vetëm me humbë? Ajo asht e padalë e s'ka pa qytet me sy. Apo e queni ma të drejtë të mos kujdesem unë për gruen time?

Ju batë që unë të largohem nga Drandja, të mos qendroj me të dhe në kinema; ajo të mos vijë e të hajë në një tryezë me mue; të mos shetisim bashkë në kohë të lirë, dhe, tue pa këto ndryshime në sjelljen tonë, thoni se Gjoka po përmirësohet. Domethanë se tue na largue ne, ju luftuet fanatizmin? Po a e dini ju se po pengoni të renë e s'po na leni me u njohtë? Deri dje ajo, sipas zakonit, nuk më thierriste as me emën, e këtu, në hekurudhë, filloi të më thotë me emën, Gjokë. Apo jo Drande? Folë!»

3

«Po, asht e vërtetë. Unë Gjokën nuk e njoh mirë. Dhe ai nuk më njeh mirë. Kish dalë atëhere fjalimi i shokut Enver, kur u fejuem. Dhe mue

Gjoka nuk më ka ble me pare e s'kam pse me qenë robina e tij, ashtu si thoni ju për sjelljen e tij me mue, se asht fanatik. Unë ha me të, ju flitni, unë rri me të, ju flitni, ai kujdeset për mue, ju i thoni pse, unë punoj me të, ju kërkonit të na ndani. Po unë nuk ndahem nga Gjoka, se kam nevojë të mësoj shumë prej tij. Dhe Gjoka po më mëson mue këtu, në hekurudhë, mue që s'kam pa veg quell me sy. Pse mos me na lan me u njoftë ma mirë?

Ju lutem thoni kush ka faj?»

4

Gjokë Çani është i mërzitur. Gjokë Çani nuk di në është fanatik. Po s'ka gjë edhe në është fanatik. Jeta e vrullshme e aksionit do ta marri me rrjedhën e vet e ai fanatizëm do të coptohet nën rrotat e trenit të punës.

Megjithatë, Gjoka nuk pranon që është fanatik.

A bisedojmë me Gjokën?

— Si po je, Gjokë?

— Si me qenë? Nuk e shef si thonë?

— Ç'të keqe ka nëse të tjerët i japid dorën gruas kur hipën në tren? Të kupto hemi, nëse ti nuk je pranë saj.

— Si me e lanë, or ti? Ti nuk e njef krahinën tonë. Ti nuk e din se, kur të kthehenë, nuk thonë që i dhashë dorën shoqes së Gjokës për me hyp në tren, por e çova hopa e Gjoka ishte atypari e nuk tha gja, budalla...

— Po në punë, Gjokë?

— Dhe për në punë ashtu kanë me thanë:
«Gjoka kish humbun andej, e na kena punue me
Dranden. A, ç'kena bisedue...»

Gjoka është fanatik, po, dashur pa dashur, ai
prishi e theu dogmat e krahinës së vet. Shumë
vetëve nuk i pëlqeu kjo gjë, prandaj kërkuan ta
vinin në vend «gabimin e Gjokës».

5

Tek e panë që u nda prej Drandes, thanë se
Gjoka po vihej në rrugë të drejtë.

Le të bisedojmë më afër me vullnetarët.

— Sikur Drandja në kinema të ishte mbësh-
tetur te supi i Gjokës e të shihte filmin...?

— Me qenë e marrë, mundej me e ba.

— Sikur ta shihnit Gjokën me Dranden duke
pirë birrë?

— Kish me u përbys tanë krahina!

Një vullnetare e tretë tha:

— A doni me jua thanë ma drejt? Çka bahet
këtu e nuk bahet në Malësi te ne, disave nuk u
pëlqen e u duket e shëmtueme. Kështu dhe Gjoka.
Po dhe Gjoka u druhet fjalëve.

Me këtë, ajo vullnetare shprehu një mendim
të madh, që e vjetra përpiqet të fshihet dhe nën
fytyrën e së resë, se një rregull i ligjshëm që ka
sunduar në malet tonë, është vështirë të thyhet.

GËRSHETI I SHTHURUR

Në anë të djathtë të rrugës automobilistike, përballë uzinës azotike, do të ngrihet stacioni i fundit. Tani atje nuk sheh gjë, veç një shesh e ara të mbjella, ku të rinj vullnetarë hapin gropat për themelat e një ure, si dhe të ndërtesave të stacionit. Me rrugën kryesore po e lidh një rrugë e shtruar me gurë. Aty do të kalojnë maqinat që do të sjellin materialin e nevojshëm për ndërtimin e stacionit. Sigurisht, s'ka asgjë interesante, asgjë tërheqëse në ato punime të tanishme, po, duke përfytyruar të ardhmen, e sheh madhështinë e punës së vullnetarëve: stacioni do të ngrihet madhështor, përballë uzinës madhështore.

Kur të bjerë rasti, pastaj, për të kujtuar punën e rinisë në këtë vepër, vullnetarët e brigadës së Elbasanit do të thonë: «Ne qemë të parët që punuam në stacionin e fundit...»

Deri këtu do të shkojë treni Rrogosjinë-Fier...

Brigada që punon këtu, është më e madhja brigadë e hekurudhës. Nga përbërja mund ta quajmë brigadë të rejash, se në gjirin e vet përbledh

187 vajza dhe 50 djem. Vajzat kanë ardhur nga Godoleshi, Polisi i Vogël, Shtërmaj dhe Bradasheshi. Ato mundohen të punojnë sa më mirë, po në fillim puna, sigurisht, ka vështirësi. Këtu ato po mësohen si të punojnë me një rregull të përcaktuar e si të zbatojnë një regjim të vendosur. Në krye të mjaft kompanive qendrojnë vajza. Nesër ato do të jenë brigadieret e ardhshme të kooperativave bujqësore. Ato do të dinë t'i organizojnë më mirë forcat në frontin e prodhimit.

Në të gjithë këtë kolektiv, që ditët e para të tërhiqte vëmendjen një vajzë me flokë të gjatë, që i binin mbi supe, valë-valë. Duket se më parë vajza i kish pasur flokët gërshetë, po i kish shthurur. Nuk di cila është ajo, as di nga kishte zbritur. Unë e shoh tek vrapon me një karrocë të zbrazët e shkon ta ngarkojë. Ajo e shthuri gërshetin qysh ditët e para të ardhjes aty. Kushedi sa luftoi me veten për ta shthurur atë gërshet, derisa një ditë e la ashtu të shthurur. S'ka gjë, do të vinte dita që ajo të vraponte pas karrocës, me flokë të prerë; veprimi i atyre ditëve tregonte se në vetë mendjen e saj luftonin dy botë: bota e zakonit dhe bota e re. Dhe përfundimi i kësaj lufte qe shthurja e gërshetit.

Me shëndet, vajzë! Më vonë ajo e preu vetë atë gërshet dhe ai mbeti aty në stacionin e fundit. Ajo u lehtësua edhe më shumë nga bota e zakonit të vjetër.

2

U bë një mbledhje organizate dhe në të u rrahën mendime të ndryshme. Dikush tha se s'i

prioste flokët, dikush tha se s'e hijte shaminë e bardhë nga koka, dikush dhe qeshi me «marrëzinë» e ndonjërës që tha se do t'i prioste flokët. Ç'do të ndodhte më vonë, nuk dihej. S'kaloi kohë dhe Bukurie Qosja, nga Shtërmaj dhe Xhemile Sulo, nga Godoleshi, na dolën midis shoqesh me flokë të prerë. Një kujtim i bukur i dy shoqeve të porsanjohura në hekurudhë. Nesër ato, kur të takojnë njëra tjetrën në jetë, do të kujtojnë se i kanë prerë flokët njëheresh. Dikush qeshi, kurse një tjetër thartoi buzët, po e nesërmja solli të pa-pritura të tjera: u ngritën vajza nga Godoleshi dhe i prenë, nga Fushëbulli dhe i prenë, nga...

Dhe habia më e madhe qe kur një mëngjez u pa në punë me flokë të prerë dhe Hatixheja.

— Mirë, moj, e bëri.

— Jo, po qe e para që kundërshtoi, dhe më shumë nga të tjerat madje.

E po ja që ajo mbrëmë mori gërvshërët dhe vajti i tha Zenepes: «M'i pre, po jo shumë të shkurtëra, aq sa të tuat...»

Kështu e përqafuan shpejt vajzat këtë të re të dëshëruar, ndonëse jo menjëherë, se zakoni ishte i rëndë dhe nuk mund ta duronte një veprim të këtillë. Vajzat panë njëra tjetrën dhe bënë si një-ra tjetra.

Aty, te stacioni i fundit, mbetën gërshtat e fundit.

Me shëndet, vajza! E nesërmja do të sjellë diçka tjetër të re.

Erdhi një ditë dhe vajzat lidhën nga një fjoongo për t'i mbajtur flokët që të mos u binin mbi sy gjatë punës. Ato lidhën flokët, po, pa e kuptuar as vetë, i shtuan dhe diçka tjetër të re vetes. Tani ato ishin më të gjirta: ballin ua rrihte era dhe një pjesë e mendimeve të vjetra kishte ikur me gërshtetin. Çdo ditë bënin jetën e thjeshtë të aksionit. Në sektor ato lavdëronin njëra tjetrën për një bukuri të re e freski të re, për një mendim të ri, që kish pushtuar botën e tyre. Shih shoqja shoqen dhe flokët po priteshin, dhe fjongot po lidheshin. Fjongo me ngjyra të ndryshme: të gjitha së bashku formonin ngjyrat e ylberit. Ato, vajzat, ishin më të qeshura, më të çelura. Shamitë e kokës s'dihet në ç'cep të fjetores kishin mbetur. Ato ngjanin si paçavra të së kaluarës, që nuk i qëndruan dot jetës së vrullshme të aksionit...

Ishte stacioni i fundit.

Po ndodhi një ditë që të gjitha fjongot dhe flokët e prerë u fshehën nën shami: atë të dielë kishin ardhur disa prind dhe vajzat s'kishin si të dilnin faqe tyre me flokët të prerë dhe fjongo të bukura. Njëra mori guximin, po nuk vendosi, *tjetra...*

*— E po fundi i fundit le të shkojmë me shami!
Dhe u fsheh ky guxim i ri nën një shami të sjellë nga fshati, u përpëlit ai me drojtje. Guxim, moj vajzë! ne s'do kërkojmë mëshirën e mendimit të vjetër këtu, po do të çajmë përpara! Dhe ja, njëra e heq shaminë dhe dolën në pah flokët e prerë, mbështjellë me fjongo.*

— I paske prerë flokët?! — çuditet prindi.

— Po, këtu në stacionin e fundit.

Të nesërmën prindët shkuan në frontin e punes dhe kuptuan se, nën gjithë ato shami të bardha, një ditë më parë qenë fshehur flokë të prerë dhe fjongo me ngjyra të ndryshme.

Me shëndet, vajza! Kështu filloi një pjesë e jetës suaj: në fillim u shthur një gërshtet, pastaj ju përqafuat të renë me vrull e guxim.

BABA ZEFI

Zef Gjoni dërgoi lajm: «U thoni atyne shokëve, nuk kam ba ndonji trimni!»

Zefi është banor i përhershëm i këtyre anëve. Rruga e re kalon përbri shtëpisë së tij. Ai dha shokët e tij për shumë vjet me radhë e kanë endërruar një rrugë të tillë, që mos të bëjnë dy ditë rrugë në këmbë sa të zbresin në qytet. Nga dritarja ai do t'i thërrasë shoferit:

— Ej, shofer, ma ruej një vend kur të kthehesh.

Që ditën e parë doli Zefi në rrugën e redhe u përzie me vullnetarët. Vullnetarët godisnin mbi shkëmb, Zefi priste shkurret. S'i tha askush. «Çdo baba Zefi këtu?» Të birin, Markun, e dërgoi vullnetar, e atij vetë nuk ju durua: mori sopatën e filloj të presë shkurret, për t'u lehtesar punën vullnetarëve.

Ai u miqësua shpejt me të rintjtë. Të nesërmen ata i shkuan në shtëpi. Nuk e gjetën aty. I priten të tjerë.

Kiske dy dhoma. Në njérën prej tyre, në dhomën e zjarrit, miqtë e rind vunë re dy ikona. E reja e shtëpisë, e kunata e Zefit, vuri re se miqtë drejtuan vështrimin nga ato ikona. Ajo ua

kuptoi mendimin dhe buzëqeshi me dashamirësi...
Kështu u hap biseda rrëth atyre ikonave. Ajo tha:

— Mungon i zoti i shtëpisë.

Një mendim të këtillë e çfaqi dhe i vëllai i Zefit, se familja në malësi ka kurdoherë «nji matë madh». Në bisedë e sipër hyri Zefi. Ai përshtëndeti miqtë e rinj me burrëri, po shtangu kur dëgjoi përsë po bisedohej.

— E, Zef Gjini, si thue, do t'i djegim këto. Shoku Enver ka thënë se duhet t'i djegim në flakë të gjitha paragjykimet.

— T'i djegim! — tha Dila, vullnetarja e brigadës së Mirditës.

— Ne i kemi djegë kaherë, — tha një vullnetar tjetër.

Biseda vazhdoi gjatë. Zefi s'ishte i qetë. Miqtë e kuptuan sa të vështirë e kishte ai, po biseda e nisur duhej çuar deri në fund... Zefi u ngrit në këmbë dhe me hapa të shpejta u drejtua nga ikonat.

Të dyja ikonat Zefi i hodhi në zjarr. E bija e tij 11 vjeçare férkoi duart nga gëzimi. Miqtë u përqafuan me të zotin e shtëpisë.

Kur Zefi mori vesh se përtë do të shkruhej në gazetë, çoi lajm:

— U thoni atyre shokëve vullnetarë, nuk kam ba ndonji trimni.

ZËVENDËSIMI

I biri kishte rënë në përpjekje me armikun. Kur erdhi i ati, ne i thamë:

— Djali nuk ndodhet tani. E kemi roje.

— E di, — tha ai, — kam prurë djalin tjetër për ta zëvendësuar në roje partizane.

(*Nga biseda e një luftëtarit përgjyarje të luftës*).

Kjo bisedë nuk ka të bëjë me ngjarjet e këtij tregimi. (Ajo thotë se, kur u vra një partizan gjatë luftës, i vëllai erdhi dhe e zëvendësoi). Po kjo përkon me ngjarjet e ditëve të sotme të punës, përkon me Shkurten: historia e ngjarjeve të ditëve tonë është një vazhdë e luftës. Unë nuk do të tregoj për Shkurten, po për një rast tjetër; heronjt e ngjarjeve jetojnë dhe sot. Ata i gjeta në udhë të hekurt.

Ishte...

Kjo ndodhi në vitin 1967, më 2 maj. Atëherë sa ishte formuar kooperativa malore. Shtinë pushkë për këtë: zakonisht pushkë shtinin kur familjes i lindte djalë, «shtylla e shtëpisë» dhe kur bëhej dasmë, se këto ishin kthesat në jetën familjare. Po jeta jonë mbruhti një kthesë të re: shtinë pushkë për formimin e kooperativës.

Si anëtar i kësaj kooperative ishte dhe një i ri, që quhej Hysni. Kish vetëm babën dhe nanën.

Më 2 maj ai dhe Mali, një shok i vet, ngarkuan mushkat me patate për t'i çuar në kooperativën fqinjë, se i duheshin për t'i mbjellë.

Rruja ishte e gjatë, e lodhshme. Mushkat djersitnin nga barra.

— Mali, një kapsulë mine.

— Ku e gjete?

— Ja...

Hysniu diç po trazonte në atë kapsulë mine.

— Kujdes, ato janë të rrezikshme!

— T'i lajmërojmë me krismë që po sjellim patatet për t'i mbjellë.

Lividhet, kështu quhej vendi, heshtnin dhe kishin freski asaj dite maji. Po Hysniua prishi qetësinë.

Një krismë.

— Hysni!

U duk sikur krisma për të dhënë lajmin shpërtheu nga grushti i tij: gishtat e dorës së majtë u coptuan.

Aksidenti ndodhi. Mali e kapi për krahu Hy-sniun dhe ktheu rrugën.

- Ku po më shpie?
- Në spital.
- Po patatet? Ata presin me mbjellë.
- Le të presin.
- Jo, do të çojmë ma parë patatet.
- Ti s'je në vete, or burrë!

Ku ishte burrë ai (!) Ai ishte nëndëmbëdhjetë vjeç.

- Ata presin. Folu mushkave, Mali!
- Po ti, nuk ke marre?...
- Mali, ti po më vonon. Unë e kuptoj se sa ma tepër të vonohemi, aq ma keq për mue.
- Hajde, pra.
- Unë po kthehem vetë në spital. Ik e ço patatet.

Një vazhdoi rrugën për në kooperativën fqi-një, ku e prisnin për patatet; tjetri u kthyte dhe vrapi tërthoreve.

Monopatet panë një nëndëmbëdhjetëvjeçar me njërin grusht të coptuar. Ai ishte vetëm, po veten nuk e lëshoi: shoku ishte nisur për të kryer detyrën.

Hysniu arriti në spital.

- Ç'ka ndodhur? — i thanë atij.
- Kishim ngarkue patate...

Në spital, Hysniut i hoqën tre gishtërinj, po dhe njërin nuk e lëvizte dot. Dhe sot e kësaj dite ai ndjen ende dhembje në dorën e majtë, ngaqë nuk është rrahu me punën.

Dhe vazhdoi të përshkonte ai tërthoret e maleve, mbas kafshëve të ngarkuara.

Ishte i ri, 19 vjeç. Shihte shokët që punonin më shumë. Dora i dhimbte.

Një natë ai shkoi në shtëpi shend e verë.

— Çfarë ke? — e pyeti baba.

— Dola vullnetar.

Nëna i tha:

— Druhem se nuk kanë me të pranue.

Po ai shkoi vullnetar.

— Udhë të mbarë! — e uruan prindët djalin e vetëm.

Kështu ështëjeta jonë: fëmijët, çdo gjë ja kushtojnë atdheut.

Ai ndenji në hekurudhë vetëm 15 ditë. Punnonte së bashku me shokët. Ditët e fundit se si u hap fjala në brigadë që dora kishte mundësi t'i rregullohej. Sa do ta dëshironë ai një gjë të tillë! Ajo vazhdonte t'i dhimbte gjatë punës.

Një ditë shkoi te mjeku.

— Për çfarë ankohesh? — e pyeti mjeku.

— Due me më rregullue dorën! Më kanë thanë se rregullohet.

— Kush?

— Shokët e mi. Ajo më dhemb ende e më pengon.

Mjeku, si e vizitoi, tha:

— Ti nuk duhet të punosh. Duhet të kthehesh në shtëpi.

— Jo, he burrë! A don me luejtë me mue?

5

Dhe një ditë ai u gjend në shtëpi. Kur e pia i ati, i tha:

— Po ti, ku i ke shokët?

— Në hekurudhë. Unë nuk mujsha me punue.

— Sa të muishe, veç të kishe ndejt me ta.

— Më përzu doktori.

I ati ndenji një çast si i zënë ngushtë. Ata ishin përballë njëri tjetrit: dy mosha, dy jetë, një mendim.

— S'ka me ndejtë kazma bosh, — tha baba.

— Më thanë shokët se do të punojnë dhe përmue, — tha djali.

6

Idrizi tani është në hekurudhë. Atë nuk e thërrasin në emër, po thonë «Babai i Hysniut». Ne tani bisedojmë qetë-qetë në një kënd të një barake. Unë mundohem të zbuloj shkaqet që e shtynë atë të zëvendësojë të birin. Po Idrizi shpregon thjeshtë:

— I thashë sekretarit të partisë: «A po më ep një shkresë, se due me shkue në hekurudhë në vend të djalit?»

— Pse, ku asht Hysniu?

— E ka kthye doktori.

Dhe ai ja dha shkresën. Idrizi erdhi në hekurudhë, vullnetar.

— Faleminderës prej brigadës, më ka pritun mirë! — thotë ai.

Kështu ai zëvendësoi të birin. Më gjatë nuk shpjegon. Dhe është e kotë të mundohesh për të zbuluar nga biseda atë diçka që e shtyu të ndërmarë një veprim të këtillë, se ky zëvendësim është i ligjshëm, është tipar i qenësishëm i jetës sonë: asnje vend nuk mund të ngelet bosh, atdheu na fton.

Dhe kështu historia e ngjarjeve të ditëve tona është një vazhdë e luftës.

8 maj 1968

ZJARR NE DËBORE

Traseja zgjatet e zgjatet. Dhe shinat mbi të zgjaten. Gjatë rrugës sheh vullnetarë. Ata janë të shpërndarë në pika të ndryshme, duke plotësuar disa punime të mbeturë: diku rregullojnë skarpatin, diku shpérndajnë zhavor, diku gërmojnë ende një kodër, diku...

Janë mbledhur aty nga gjithë Shqipëria. Kanë ardhur dhe nga fshatrat e Përmetit. Ka aty nga zona e Frashërit, nga Çerçova... Dhe këta ruajnë në kujtesë ngjarje të lindura në trase, gjatë dy muajve. Dhe bëhen këto ngjarje një shkollë e qendresës së kolektivit për një guxim të mëtejshëm. Do të kalojnë kohë dhe ata do të tregojnë:

Ishte njëherë...

Fjala është për një trase. Bie shi. Karroca nuk ecën dot: rrota e saj ngarkohet me baltë dhe s'lëviz. Është baltë Myzeqeje ajo, baltë e zezë. Shiu bie, kërcet mbi mushama. Ç'të bëjnë?

Puna nuk ecën. Dheu gërmohet lehtë. Ah, sikur të kishim një qerre, ta ngarkonim mirë e mirë e pastaj ta tërhiqnin dy qe, dy buaj, në rrugën me baltë... Ç'ëndërr! Ëndërr vullnetari në ditën me shi.

— Ej, djema!

Dy vetë rrëmbejnë karrocën dhe e ngrenë peshë. Le të kalojë mbi supet e tyre çdo gjë: dhe balta dhe karroca e traseja të shtrohet. Ata do ta mbajnë barrën e rëndë. Janë të rinj.

Ishte...

A e dini çfarë? Foti la karrocën dhe ju afrua vajzave që i ngarkonin ato me dhe. Kapi e ktheu fundin e mushamasë dhe i tha një shoqes së vet:

— Mbushe!

Ajo angiti sytë dhe pa. Dy shpatulla të gjera qëndronin përballë saj. Dy shpatulla dhe një fund mushamaje, i gatshëm pér të pritur dhe.

— Ku e ke karrocën?

— Hidhe mbi mushama.

Po ky i marrë!? Vajza nuk bën asnjë veprim. Të tjerë japid e marrin të shtyjnë karrocat. Rruga ka baltë. Balta ngjit. Karrocat nuk çajnë.

Dhe vajza hedh një lopatë dhe. Dheu kërcet mbi mushama. Të tjerët qeshin:

— Mirë i ka vajtur mendja.

— Mbushe plot!

Mbushet një mushama me dhe. Një karrocë mbetet në rrugë. Afrohen të tjerë vullnetarë dhe vajzat u mbushin mushamatë me dhe.

Një ditë shiu është ajo. Tani le të bjerë shi! Për t'u ngarkuar me dhe vijnë dhe vajza. Po ato i largojnë. Njëri bën shaka:

— Kemi marrë zotim të mos ngarkohen gratë.

— Hidhe, moj motër, dhe një lopatë, se u pa kjo punë!

Kalon karvani i vullnetarëve i ngarkuar me dhe mbi mushama. Karrocat mbeten në rrugë. Kush e pa atë ditë atë karvan që çante rrugën me baltë tha:

— Shiko vullnetarët!
Bie shi. Le të bjerë shi!

Ishte...

Fjala është përsëri për në trase. Në tri ditë të ftohta, gjatë janarit, ra dëborë. Dëbora rrallë bie në Myzeqe.. Dhe dimrat me dëborë mbahen si më të ftohtët.

Qielli i përhimitë. Floku i ftohtë i dëborës bie mbi duar vullnetarësh dhe shkrin. Vullnetarët, të mbledhur me mushama, lëvizin me veglat në duar, se traseja do punë...

— Ej, mik, punë!

Një hukat duart. Duart memzi e mbajnë venglën. Dikush ndez një zjarr. Sa mirë i ka vajtur mendja, zjarr në dëborë! Dhe aty rreth zjarrit grumbullohen vullnetarët për t'u ngrohur. Të tjerë punojnë, shpejtojnë. Pastaj ata çohen, shkojnë te shokët, për t'u marrë veglat.

— Kaloni ju, shokë, tani!

Dhe kështu, nga tre-katër, ata kalojnë te zjarrri. Ai ngjan si një stacion i vogël, ku njerëzit marrin zjarr, për të puhuar më me forcë, për të shtyrë karrocat më me vrull.

Dëbora bie. Ata nuk e ndërpresin punën. Kështu e kanë ata, në vështirësi gjejnë rrugë të reja. Kush i pa ato ditë tha:

— Shiko vullnetarët!

Bie dëborë. Le të bjerë dëborë!

Ishte...

... Kjo është një ngjarje tjetër, që u përket vullnetarëve të brigadës «Ngjeli Gogo» të Përmetit. Në të vërtetë duket se ka të bëjë me një rrez të veçantë, po i përket gjithë një kolektivi, se kushdo nga ata, në një ose në një tjetër mënyrë, e ka treguar veten se është i gatshëm përcdo sakrificë.

Ishin tre vetë: Vitoria, Minella dhe Feriti. Të tre kanë një histori të vetme, pa çka se ato ndodhën në ditë të ndryshme.

Ditët e dimrit. Nga kolektivi mungojnë në punë vetëm tre vetë. Ata kanë disa ditë që mungojnë, se kanë raport pushimi. Të tjerët punojnë.

I pari që vjen në punë është Minella. Ai nuk doli herët, se kishte pushim. Ndofta kish ardhur të shohë shokët. Sidoqoftë, dhe kjo është mirë: ai së shpejti do të kthehet te shokët. Po Minella pa pyetur njeri shkon e kap veglën e punës.

— Minella!

Mos e pengoni. Ai e di që ka pushim, po mërzitet vetëm atje, të qyteza, se është mësuar me punë.

— S'të gjen e keqja nga puna, vëlla, jo!

Minella s'do të ndahet nga shokët asnjë çast. Ai kaloi me ta një muaj e gjysmë e s'mendon më tanë përvete. Dhe ai punon me aq sa mundet, pa çka se ende s'i ka mbaruar pushimi. Askush nuk mësoi se ç'bëri Minella. Kështu janë këta, vullnetarët. Duket sikur veprojnë me kokën e vet, po çdo veprim është mendimi i lartë që ka mbrujtur te ata kolektivi.

Të nesërmen, më 16 janar, erdhi Feriti. Dhe

ai nuk deshi t'i bënte të gjitha ditët e pushimit. Në vetmi ai nuk mendoi më për vete, po për shokët e punës, prandaj e ndjeu **veten** më të fortë midis tyre. Vitoria u ndodh midis shoqesh më 17 janar...

Mua më tregojnë për ata të tre.

Ishte...

Mendimi për shokët asnjëherë nuk i le të qetë: gjithkush nga ata **kryen punën e duhur**. Kur sheh se shoku është në punë të vështirë, ai vete dhe e ndihmon.

Njëherë bënë një mbledhje. Mbledhje vullnetarësh për të dalë sérishmi vullnetarë. Një foli me zjarr, një shprehu një **mendim**, po dhe ai që s'tha një fjalë, ngriti dorën, për të treguar se ishte i gatshëm. Dhe 95 vetë, aty në hekurudhë, muarën një vendim, për të cilin i shkruan dhe letër shokut Enver. Në të thuhej se, mbasi të kthehet e nëpër vendet e tyre, do të shkonin përsëri 15 ditë vullnetarë për të prerë shtylla e për të hapur grupa për vendosjen e tyre, se elektrifikimi i vendit duhet të kryhet sa më parë. Gjatë këtyre 15 ditëve ata do të hapnin dhe rrugë.

Kur t'u bjerë rasti t'u tregojnë të tjera për ndërmarrjen e vet, ata do të thonë:

Ishim në hekurudhë...!

24 janar 1968

XHA KADRIU

Xha Kadriut ju prish gjumi.

Xha Kadriu erdhi vërdallë nëpër Zagorçan, vetullngrysur e gojëlëshuar, se e bija... Ah që s'mundi t'ja digje fjalën më urë të zjarrit, sa pa e nxjerrë ajo nga gojal... «Po ç'i duhej, askush nuk e shtrëngoi ta thoshte të shkretën fjalë, apo deshi të dukej si kali balash? Ç'u prish kjo mendja e njerëzve, ç'u prish! Të ngrihet bijë e botës, papritur e pakujtuar, të thotë se do të shkojë në udhë hekuri. Pse, moj, njeri i panjeri je ti?»

Kjo ja prishi mendjen xha Kadriut dhe thoshte shpesh se nuk po i shkonin punët mbarë. Ai dha e mori me të bijën, pô e bija nuk u dha. Se kujt i ngjau ajo, as ai nuk po e merrte vesh.

Dhe tha xha Kadriu:

— Unë nuk e lë.

— Po ajo vendos vetë, xha Kadri.

Dhe tha xha Kadriu:

— Nuk lihet vajza vetëm, do të shkoj dhe unë me të.

Dhe erdhi ai nga Zagorçani. Pa ai një javë me radhë se ç'bënин këto vajza aty, pastaj u ngrit e iku për të qetësuar dhe të tjerët.

— Mirë se vjen, xha Kadri! Si shkon vajza?
Xha Kadri thotë:

— Paskemi qenë budallenj, unë dhe ju!

Pastaj xha Kadriu tregon për trasenë, për shinat e hekurta, për vrullin e rinisë, për vajzat që marrin pjesë në kurse, për mbrëmjet e vallëzimit, për ato pantallonat që kishin veshur dhe për këngët që këndonin...

— Po ti këndove, xha Kadri?

— Oj këndova, thotë! Këndova dhe punova që ç'e me të! Dhe shikoni, po të kishte ndonjë të keqe, nuk ikja unë andej, jo. Jam dhëpër plakë, unë!

Dhe xha Kadriu tanimë nuk fliste gojëleshuar e vetullngrysur. Ai kalonte kudo e tregonte histori vullnetarësh. E bija punonte në hekurudhë me 14 vajza të fshatit.

Me t'u kthyer nga aksioni, e bija e Kadri Cakës, u bë brigadiere. Fshati pëshpëriti se si duronte xha Kadriu, po ai thoshte me vete: «Budallenjtë, nuk kanë qenë në hekurudhë!»

Dhe ai vetë krenohej që kishte qenë në hekurudhë. Kishte parë e kishte ndryshuar mendimin për «punët që bëhen atje», prandaj i priste me gjakftohtësi ndryshimet që po ndodhnin në fshat, me kthimin e vullnetarëve. Ndonjë dhe mblođhi buzët, po xha Kadriu tha:

— I njoh unë ato, në aksion...

Vetë ai luftonte e ndeshej me mendimet e vjetra, duke përshëndetur me entuziazëm çdo të re që po hynte në fshatin e vet.

Ne s'njihemi, xha Kadri, as jemi parë ndonjëherë në jetë, po si thua, a po fle i qetë tan? Apo

përsëri ke kokëçarje se të shqetëson ndonjë që nuk i pëlqen puna e vullnetareve të ardhura nga aksioni. S'ke ç'bën, xha Kadri, duhet luftuar deri në fitore, se dhe ti vetë ke qenë një javë vullnetar. Po të rinxjtë mësuan më shumë nga ti, se ndenjën dy muaj, në Dushk, në vendin ku punoi e ra Shkurta, trimëresha e Dukagjinit. Bijat e fshatit tuaj e njohën atë, xha Kadri...

Mars, 1968

MËSUESI

1

28 qershor.

Qytezat vullnetare u zgujan në festë. Dhe kjo ditë është në jetën e aksionit si ditë e ngjarjeve të mëdha.

Ajo që i dha tufën me lule shokut Enver, quhej Valbona. Ishte vullnetare e brigadës «50 vjetori i pavarësisë», e ardhur nga shkolla e Kombinatit të tekstileve «Stalin». Ajo qe e para, ndër vullnetarët, që i uroi mësuesit mirseardhjen dhe e përqafoi...

Të gjithë, pastaj, i uruan mirseardhjen. Udhëheqësi i takon vullnetarët një për një. Mes brohoritjesh dëgjohen biseda të shkëputura. Ai pyet. Ata përgjigjen. «Parti, Enver, jemi gati kurdoherë!»

Një çast njojjeje: midis vullnetarësh, kryein-xhinieri i urës së Rrogosjinës.

— Andrea Papastefani, — ja paraqitet.

Mësuesi vështron, kujton, e njeh:

— Po ju keni qenë nxënësi im.

Po, në vitin 1938, Andrea kishte qenë nxënës

në liceun e Korçës. Mësuesi e kujton mirë mbas kaq vjetësh. Andrea më vonë kishte dalë partizan, kishte shërbyer në ushtri, kishte marrë maturën si kandidat i jashtëm dhe kishte vazhduar studimet e larta. Pastaj kishte ndërtuar, kishte dhënë mësimë në fakultet, ishte kandidat i shkencave dhe kishte ardhur të ndërtojë me vullnetarët urën e Rrogozhinës, urën më të madhe të këtij tipi në vendintonë. Ai i raportoi mësuesit:

— Ju njoftojmë shoku Enver, se sot përfundojmë betonimet kryesore në urën e Rrogozhinës...

Udhëheqësi merr të dhëna të hollësishme për urën. Gjithë rinia është në bashkëbisedim me të. Vepra e saj tregon: për brigada të zbritura nga malet, të ardhura nga fushat gjatë gjithë turneve. Ja tek janë shokët e tyre, vullnetarët e këtij turni. Ata brohorasin.

2

Shkurta qe mishërimi i ideve të partisë, vepri i saj mbeti kurorë e heroizmit rino. Ku ra ajo, është ngritur një lapidar. Aty tanë bëjnë roje pionierët, vullnetarët.

Shumë vizitorë, të ardhur nga të katër anët e atdheut dhe vende të ndryshme të botës, e kanë parë këtë lapidar. Sot aty vjen mësuesi i rinisë, me veprën e të cilit Shkurta u hodh në vrullin e rinisë vullnetare.

Udhëheqësi i partisë kalon tanë në ato rrugë, ku Shkurta shtynte një karrocë me dhe, që tra-

seja të rritej edhe më. Po me veprën u irrit dhe ajo. Traseja tanimë ka mbaruar dhe është shtruar me shina të çelikta. Aty kalon treni i punës që mbart ndjenjet dhe ëndrrat e rinisë.

Te lapidari i bijës së partisë, udhëheqësi vendos një kurorë: «Cucës heroike të Dukagjinit, komunistes 15 vjeçare, Shkurte Pal Vatës — Enver Hoxha».

Pastaj ai hesht. Vështrimi i tij është përgendruar te lapidari. Kalon një minutë. Mësuesi, duke nderuar kujtimin e nxënëses, përulet...

Shkurta ra për veprën e partisë.

3

Në sektorin e Gradishtës thua se është mbledhur e gjithë Shqipëria, me 8000 përfaqësuesit e vet, vullnetarë të këtij turni; erdhën aty me treinin e punës, me autobuza; vullnetarët e sektorit të Libofshës u nisën në këmbë...

— Arritën!

Udhëheqësi ynë, i shoqëruar nga Shoku Ramiz Alia, kalon midis vullnetarësh. Dhe ata ngjajnë si vullnetarë: në qafë kanë lidhur shaminë e aksionit.

Gaz, hare! Gjithkush mundohet të takojë shokun Enver. Kur e takon, vullnetari gazmohet.

Një çast bisede. Shoku Enver pyet:

— Nga je ti?

Vullnetarja nuk pret më po e përqafon. Ka rreth saj të tjera malësore që brohorasin. Broho-

rasin studentë, nxënës: 8000 vullnetarë shprehin gatishmiérinë e tyre.

Unë nuk di se kush qe ajo vajzë malësore, se kish aty nga zonat e thella të Kukësit, të Tropojës, të Peshkopisë, të Matit... Unë pata mësuar para disa ditësh, kur kaloja nëpër sektor, se një grup vajzash të malësisë po preqatiteshin t'i dërgonin mësuesit një letër, ku do të theksonin se kishin ardhur me një barrë mbeturinash dhe kishin nisur luftën kundër tyre këtu, në aksion.

Ndofta do të ishte ndonjëra prej tyre. Apo ndofta ndonjëra nga ato malësoret që dhe në orët e vona të natës lexojnë materialet e partisë.

Udhëheqësi përshkon radhët e vullnetarëve, Brohoritje, takime, përqafime.

4

Në sallën e kulturës pak minuta çlodhje. Se si u zhduk ajo drojtje, askush nuk e kuptoi, ahe nga një raportim zyrtar i kryeinxhinierit, për hekurudhën, çdo gjë kaloi në bisedë të përzemërt. Kryeinxhinieri, Shkëlqim Bumçi, tha:

— ... Mendojmë që nga fillimi i tetorit të përfundojmë punimet.

— Këta të nderojnë! — tha shoku Enver, duke e patur fjalën për vullnetarët. — Me të tillë të rinj ne krenohemi...

Pati aty biseda nga më të ndryshmet. Gjithkush fliste pa drojtie, për punën, për jetën në aksion dhe... për lodhjen.

— Shumë kanë mësuar të shtrojnë e të montojnë shina, shoku Enver.

— A i keni pajisur me ndonjë dëshmi?

— Jo!

— Duhet të pajisen. Ndihet nevoja e montatorëve të shinave dhe ata do të jenë gjithmonë të gatshëm, se e kanë mësuar mjeshtërinë...

Biseda kalon nga një sferë në tjetrën, bisedë e qetë, e përzemërt. Shoku Enver interesohet për ushqimin, për orarin e punës, për aktivitetet, për gjithë jetën deri në hollësi.

— Sot duhet të jeni çlodhur ca.

— Jo, u ngritëm që në orën dy e gjysmë për t'Ju pritur — Ju tha një.

Ndonjëri dhe u mundua ta fshehë këtë rast. Po mësuesi tha:

— Dhe unë, kur u nisa për këtu, thashë se sot vullnetarët e kanë ditë pushimi e do të flenë më shumë...

Dhe pyet mësuesi për shëndetin e vullnetarëve. Dhe bisedon ai si mund të organizohet më mirëjeta në aksion.

Një student tha:

— Kemi ngritur grupet e edukimit në brigada.

— Rinia shkollore e fshatare janë shkrirë në të njëjtën brigadë, — vërejti një tjetër.

— Mësimet e partisë jatin mundësi për krimjin e formave të shumta të punës, — tha shoku Enver. — Dhe këto forma ne do t'i mësojmë nga ju të rinjtë, se ju i njihni dhe më mirë.

Biseda të thjeshta, biseda të ngrohta, biseda për anët më të ndryshme të jetës. Shkëmbëher mendime vullnetarësh me udhëheqësin.

Shoku Enver deshi të ditë për gjithçka.

Mbresat e fjalimit që shoku Enver mbajti në Gradiشتë, mbetën në mendjen e vullnetarëve si një program i madh pune për të ardhmen në drejtim të edukimit ideologjik dhe të kalitjes revolucionare.

Ndodhem në brigadën «Heronjtë e Vigut» të Mirditës. Bisedohet aty në një rrëth vajzash: ka nga Tarazhi, që rriti heroinat Marta dhe Prenda, ka nga Kaçinari, nga Rasi, ngado... Vendin e shamilive të sjella nga malet, tani e kanë zënë fjongo të ngjyrave të ndryshme.

Ja Draneja, është kooperativiste. Tani këtu është zëvendëssekretare e organizatës.

— Unë s'dija si me veprue në fillim, po më ndihmuen nxanësit e shkollës si me e krye detyrën.

Aty është dhe Dave Prenda. Ajo është komandante e brigadës, nxënëse e klasës së X-të, është dhe Bardha Kaqorri, që ndeji në tribunë së bashku me shokun Enver; janë aty plot malësore, që u takuan me mësuesin.

Po u tregojë disa biseda të shkëputura nga koha e bisedimit të lirë gjatë çlodhjes në dhomën e kulturës:

— Shoku Enver u interesua aty dhe se si e keni ushqimin.

Dila tha:

— Kur ishte në Mirëditë, ai na këshilloi me u la me sapun.

— Dhe na pyeti sa sapun harxhojmë në familje, — vërejti një tjetër.

Në bisedën time s'kisha thënë asgjë të re. Ato e njihnin nga afër mësuesin e vet, që ishte interesuar për çdo gjë të jetës së tyre.

MIRËMËNGJEZ, ATDHE!

1

Përshëndet rinia e vendit, duke i dhuruar atdheut një vepër të re:

Mirëmëngjez, atdheu im, mirëmëngjez! Dëgëzimi i hekurudhës së rinisë Rrogozhinë-Fier, ngjan si një llastar i mbirë në trungun kryesor të hekurudhës, ushqyer me gjallérinë, krenarinë, bukurinë, guximin, djersën, heroizmin. Sot, dy vjet më parë kohës së caktuar për ndërtim, në prakun e ditëlinjës së mësuesit të vet, rinia e vendit inauguron veprën madhështore: aty punuan 65.000 vullnetarë të ardhur që nga Jugu i largët e Vermoshi i lartë, nga bregdeti i kaltërt e kufiri i pamposhtur, duke kryer $1.603.098 \text{ m}^3$ lëvizje dheu, në 54 km. trase të linjës kryesore e në 7,8 km. linja të dyta dhe duke ndërtuar 191 vepra arti (175 mbi hekurudhë dhe 16 në rrugë nationale)... E mbi të gjitha, ajo kaliti vetveten me ideologjinë e partisë dhe mësimet e shokut Enver, duke e kthyer aksionin në një shkollë të edukimit revolucionar. Ndaj rinia e vendit brohorit me shpirt e dashuri:

Mirëmëngjez atdheu im, mirëmëngjez! Të për-

shëndet rinia e afateve të shkurtuara të pesëvjeçarëve.

Rroftë rinia!

2

Mirëmëngjez, atdhe! Sot ka ardhur të marrë pjesë në gjësim mësuesi ynë i dashur, shoku Enver. Kjo është krenaria më e madhe për veprën tonë. Ai e ndoqi me vëmendje gjatë gjithë kohës, punën tonë dhe, kur u ndodhëm në vështirësi, na mësoi si t'i kalonim; dhe, kur hasëm pengesa, na frymëzoi optimizmin e së ardhmes e ne muarëm zemër e kaluam çdo pengesë. Urra! Mësuesi ynë sot, këtu, në stacion të Rrogozhinës, pret shiritin e veprës së re. Kjo është një ndër fitoret tona të pesëvjeçarit që ne, brezi i ri, e presim me lule....

Treni vërvshëllen për herë të parë në një rrugë të re në rrugën e hekurt. Treni sot është i rrethuar me flamuj përfestën e madhe dhe mbartëndërrat e riniše: me të sot udhëton vetë shoku Enver, të ftuar të tjera dhe vullnetarë. Me mësuesin udhëton rinia vullnetare, që e vati gjithmonë vullnetar të hekurudhës, në gjëzimet e përpjekjet e veta. Ndaj sot këngët gjatë rrugës së hekurt i kushtohen partisë, luftës dhe përpjekjeve tona për të ndërtuar dhe mbrojtur fitoret.

Ndihet vërvshëllima e zgjatur e trenit. Dushk. Këtu ra Shkurta: Mësuesi vështron nga dritarja. Shkurta, e derdhur në bust, përshëndet mësuesin me tërë gjallërinë, bukurinë, heroizmin, krenarinë e riniše.

Shkurta përshëndet me kazmë drejt horizonteve dhe me grushtin e mbledhur. Unë kam pranë një

të moshuar. Nuk di nga është ai, por di që është i ftuar të marrë pjesë në veprën e rinisë.

— A, shumë mirë, me grusht!

— Si!?

— Me grusht! — thotë ai i papërbajtur. — Dhe gjatë luftës kështu i shembëm barikadat e armikut, me grusht.

Në fjalën e atij burri unë pashë dhe të vërtetën e sotshme: ne me grusht i shembëm muret e kanuneve e zbritëm në aksion, organizuam kuvendet e me grusht dërmuam konceptet e shtrydhëm prapambetjen dhe dualëm në jetë ballëhapur, duke thurur këngë për partinë. Kështu çamë përpara rrugën në aksione, me grushtin lart, se kështu na mësoi partia; të paepur.

3

Treni çan përpara me vërvshëllimë. Gjatë rrugës e në stacione janë grumbulluar të mëdhenj e të vegjël, të ardhur nga fshatrat e Myzeqesë. Urra! përshtëndesin trenin, përshtëndesin rininë.

Në stacionin e Fierit përshtëndesin vullnetarët. Ata kanë gjokse të zbukuruara me shenjat e sulmuesit . . .

Unë shoh Fuat Çelën. Ai ka dalë shtatë herë sulmues. Unë shoh Pal Vatën. Ai e mban mend fare mirë, se kur e pyeti të bijën në spital për shëndetin, Shkurta i tha: «Jam mirë, unë e lëviz kambën!» dhe në të vërtetë lëvizi këmbën e saktë, se tjetrën e kishte të coptuar. Po ky ishte dhe mendimi i madh i rinisë, i përgjithësuar te veprimi i saj: rinia nuk

mund ta kuptojë jetën në qetësi, pa lëvizje, pa gjallëri, pa bërë diçkà të dobishme për atdheun. Ja pra, ky është treni që mbar mendimin revolucionar të rinisë. për të kaluar nga aksioni në aksion. Unë shoh Hane Skuraj, nënën e Shkurte Carrës, shoh dhe Pashkën, të bijën e Marta Tarazhit, dhe të gjitha këto pika nyje japid ato ndërthurje të heroizmit të rinisë që nga vitet e luftës e aksionet e para e deri në ditët e sotshme.

Unë kujtoj bisedën e disa ditëve më parë, kur u inaugurua busti i Shkurtës: flitej në do të vinte vetë shoku Enver në inaugurimin e hekurudhës. Nuk di kush qe ajo grua që ndërhyri në mes.

— Enveri i përket rinisë, or bir! Patjetër do të vijë.

Në tribunë, shoku Enver dhe udhëheqës të tjerë të partisë e të pushtetit:

Urra! Sa shumë janë mbledhur sot në miting. Unë kujtoj fjalën e thjeshtë të asaj myzëqareje, thënë për mësuesin e madh.

Fier 12-10-1968

L E N D A

Faqe

1. Krimbi i fjetur që hapi sytë	3
2. Pika e largët	8
3. Biseda të ndërprera	15
4. Fusha e djallit	19
5. Kthesa	25
6. Gërshetim vallesh melodish	29
7. Dritare të mëdha	33
8. Luftë me qiellin dhe baltën	41
9. Ngjarje në rrugë	45
10. Krenari	50
11. Shthurrja e gardhit	52
12. Monolog	58
13. Buzë liqenit	61
14. Mirditorët	64
15. Kudhra	70
16. Xhani mamit — vullnetar	72
17. Karroca kokërrrotë	76
18. Kuvendim me malet	81
19. Gërsheti i shthurur	87
20. Baba Zefi	92
21. Zëvëndësimi	94
22. Zjarr në dëborë	100
23. Xha Kadriu	105
24. Mësuesi	108
25. Mirë mëngjerez Atdhe!	114

Tirazhi 4000 kopje Format 70x100 /32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1969

STABILIMENTI «8 NËNDORI» — TIRANE 1969